

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - neni 386 LPK dëmshpërblimi - revizioni i pranuar - urdhërimi i rigjykimit - neni 395(2) LPK]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Gjykata Supreme ka rrefuzuar ankesën e të paditurit dhe ka aprovuar ankesën e paditësit duke e obliguar të paditurin të paguaj dëmshpërblim për transportimin e mallit të padorëzuar.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është e bazuar.

Rev.E.nr.3/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylfiu, Gjuran Dema, Osman Tmava dhe Zait Xhemajli, anëtarë, në kontestin e paditëses Ndërmarrja “Korabi”, muzikë elektronike, në Gjilan të cilën e përfaqëson Iljaz Ramajli avokat nga Prishtina, kundër të paditurës NTP “Nderi”, me seli në fshatin Tërn, komuna e Ferizajit, për dëmshpërblim në vlerë prej 8.876,62 €, përkitazi me revizionin e së paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr.82/2004 datë 31.01.2005, në seancën e mbajtur më 21.07.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i të paditurës, prishen aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr.82/2004 datë 31.01.2005 dhe ai i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë C.nr.275/2003 datë 02.09.2004, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ae.nr.82/2004 datë 31.01.2005, është refuzuar si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë C.nr.275/2003 datë 02.09.2004, me të cilin është pranuar kërkesëpapia e paditëses dhe është detyruar e paditura që paditëses t'ia paguajë në emër të dëmshpërblimit për mallin e dhënë për transportim, e të padorëzuar, shumën prej 8.876,62 €, me kamatë sipas normës vjetore në lartësi prej 3% konform me shkallën kamatore të mjeteve të deponuara në Bankën Komerciale, pa destinim të caktuar në afat mbi një vit, duke filluar prej 13.10.2003 deri në pagesën definitive dhe në emër të shpenzimeve kontestimore, shumën prej 1.103,20 €, të gjitha në afat prej 8 ditësh, pas pranimit të aktgjykimit, me kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulëta të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësja ka paraqitur përgjigje në revizion me propozimin që revizioni e të paditurës të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të LPK, ka gjetur se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja me padi kërkon që të detyrohet e paditura që asaj t'ia paguajë në emër të dëmshpërblimit për mallin e dhënë për transportim e të padorëzuar, borxhin në vlerë prej 8.876,62 €. Nga parashtesa e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, sektorit të hetuesisë të datës 27.04.2004, del se e paditura nuk e ka deklaruar vlerën reale të mallit, pasi që, gjatë kontrollimit janë gjetur faturat origjinale për mallin kontestues të transportuar-për zërim dhe ndriçim në vlerë prej 5.468,82 €, ndërsa në bazë të specifikacionit të deklaruar, shifet se e paditura ka deklaruar vetëm një pjesë të mallit të cekur, prandaj komisioni për kundërvajtje doganore ia ka shqiptuar të paditurës dënimin përkatës, për shkak të mos deklarimit të vlerës reale

të mallit të transportuar dhe, nga kjo bazë ia ka sekuestruar mallin.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe ka detyruar të paditurën që asaj t'ia paguajë shumën prej 8.876,62 €, në emër të dëmshpërblimit. Duke vendosur sipas ankesës së të paditurës Gjykata Supreme e Kosovës, ankesën e saj e ka refuzuar si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, gjykata e revizionit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilin shkak të dy aktgjykimet janë prishur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar që në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se, paditësja paraprakisht i ka paguar shpenzimet e transportit për mallin kontestues në lartësi prej 1000 SFR, përkatësisht kundërvlerën e tyre prej 600 €, ndërsa është kontestuese fakti se, në barrën e kujt bije përgjegjësia për bartjen e shpenzimeve të kompensimit të dëmit, për shkak të sekuestrimit të atij malli, nga ana e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut të Kosovës, për shkak të mosdeklarimit të vlerës reale të mallit në tërësi, por vetëm një pjesë të mallit, (instrumenteve muzikore), prandaj komisioni për kundërvajtje doganore ia ka shqiptuar të paditurës dënimin përkatës, për shkak të mos deklarimit të vlerës reale të mallit të transportuar.

Gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar t'i kërkojë shkresat e lëndës për kundërvajtje doganore, nëse është zhvilluar procedura për kundërvajtje doganore dhe çfarë dënimi është shqiptuar të paditurës për shkak të mos deklarimit të vlerës reale të mallit, kjo për arsye se në shkresat e lëndës nuk gjenden shkresat e lëndës të komisionit për kundërvajtje doganore, por vetëm procesi mbi kundërvajtje doganore nr.172 i përpiluar më 18.10.2003, prej të cilit nuk mund të konstatohet masa e shqiptimit të dënimit. Përveç kësaj gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar të dëgjojë në cilësinë e dëshmitarit B.I. i cili ka qenë i angazhuar në cilësi të menaxherit të ndërmarrjes paditëse lidhur me transportimin e mallit.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim, t'i mënjanojë të metat e sipër përmendura, t'i kërkojë shkresat e lëndës, të

komisionit për kundërvajtje doganore, të dëgjojë në cilësinë e dëshmitarit B.I. dhe personat të cilët kanë lidhur marrëveshje, për mallin e transportuar si dhe mënyrën e paraqitjes të mallit për zhdoganim lidhur me deklarimin e vlerës reale të mallit të transportuar nga Curihi për në Gjilan dhe, me administrimin e provave të tjera të nevojshme, t'i vërtetojë të gjitha faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje dhe, pas vlerësimit të drejtë të provave, të marrë vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 395 par.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPRME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.E.nr.3/2005, më 21.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - Neni 386 LPK - kthimi në vendin e punës - kompensimi i pagave - revizion i aktgjykimit - revizioni i pranuar - urdhërimi i rigjykimit vazhdimi i mardhënies së punës neni 9, 11 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/7 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut e ka obliguar dhe urdhëruar të paditurin që paditësin ta kthejë në vendin e punës. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme ka vendosur se rrethanat që kanë të bëjnë me përsëkrimin e detyrave të punës së paditësit në vendin e tij të punës nuk janë vërtetuar, respektivisht nuk është vërtetuar se a janë plotësuar kushtet mbi themelimin e mardhënies siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/7 Mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë vërtetuar se cilat janë ato veprime që kanë rezultuar në shkeljen e mardhënies së punës dhe si është kryer ajo shkelje. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është e bazuar.

Rev.nr.18/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqarët: mr.sc. Rifat Zylfiu, kryetar, Shahdane Agani, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit F.D., nga Hani i Elezit, të cilin e përfaqëson Ilaz Ramajli, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Sharr Beteiligungs GmbH, Fabrika për prodhimin e çimentos “Sharcem”, Hani i Elezit, për kthimin në punë dhe shpërblimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, sipas revizionit të së paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.464/2003 datë 8 nëntor 2004, në seancën e mbajtur më 20 korrik 2005, mori

A K T V E N D I M

PRANOHET revizioni i të paditurës, PRISHEN aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.464/2004 datë 8 nëntor 2004 dhe i Gjykatës Komunale në Kaçanik, C.nr.78/2002 datë 27 qershor 2003 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.464/2003 datë 8 nëntor 2004, pjesërisht është pranuar ankesa e të paditurit, ashtu që është refuzuar si e pabazuar pjesa që ka të bëjë me par. I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, C.nr.78/2002 datë 27 qershor 2003, me të cilin është anuluar Vendimi i të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, nr.LA/862 datë 3 qershor 2002 dhe është detyruar e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës drejtor teknik te e paditura ose në ndonjë vend tjetër me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa është pranuar ankesa, është prishur i njëjti aktgjykim i gjykatës së shkallës së parë nën par. II të dispozitivit i cili ka të bëjë me detyrimin e të paditurit që paditësit t'i shpërblejë të ardhurat personale me kamatë ligjore dhe nën par. III të dispozitivit i cili ka të bëjë me shpenzimet e procedurës dhe lënda në këtë pjesë iu ka kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

E paditura me kohë ka paraqitur revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e cekura të gjykatave të instancës më të ulët të prishen në pjesën që kanë të bëjnë me prishjen e aktvendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit dhe kthimin e tij në punë te e paditura dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur revizionin është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë me provat e administurara ka vërtetuar se paditësi pa kurrfarë kontrate të

punës ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura që nga 13 qershor 2000, i radhitur në vendin e punës drejtor teknik. Punët i ka kryer deri më 3 qershor 2002 kur me Vendimin e të paditurës LA/862 datë 3 qershor 2002, i u ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të shkeljeve të detyrave të punës moskryerjes me kohë të punëve dhe detyrave të punës të cilat sipas pozitës ka qenë i detyruar t'i kryej. E paditura e ka komercializuar fabrikën e çimentos në Han të Elezit sipas kontratës me të cilën është paraparë detyrimi i të paditurës për përmirësimin e prodhimeve dhe investimeve. E paditura nuk i ka përbushur detyrimet kontraktuese për të cilën arsye paditësi ia ka tërhequr vërejtjen. Për këtë shkak janë keqësuar marrëdhëniet mes paditësit dhe të paditurës dhe e paditura me vendimin e saj paditësit nuk ia ka shqiptuar masën disiplinore për shkak të shkeljeve të detyrave të punës, por për shkak të kritikave të cilat paditësi ia ka bërë të paditurës. Para se t'i shqiptohet paditësit masa disiplinore e paditura nuk ka zhvilluar kurrfarë procedure për vërtetimin e shkeljeve të detyrimeve nga marrëdhëniet e punës, cilat janë ato shkelje dhe me çka kanë të bëjnë. Gjykata e shkallës së parë si provë për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me detyrimet e punës ka bërë administrimin me shikimin e tekstit të kontratës së punës e cila gjendet në shkresat e lëndës, por e cila nuk është nënshkruar në mes të palëve ndërgjyqëse si punëdhënës dhe i punësuar dhe se tekstin e kësaj kontrate nuk e ka nënshkruar paditësi për shkak se, siç theksohet, të frikës se eventualisht mos do t'i zbriten kontributet të ndryshme dhe do t'i zvogëlohej rroga.

Duke u nisur nga kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit është marrë në kundërshtim me dispozitat e neneve 11, pika 11.5 dhe 11,5 nën B të Rregullorës së UNMIK-ut, dhe si të paligjshëm e ka anuluar, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të asaj gjykate nën par.1 dhe e ka detyruar të paditurën që të kthejë paditësin në punë në vendin e drejtorit teknik apo në ndonjë vend tjetër me të gjitha të drejtat nga marrëdhëniet e punës.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit që ka të bëjë me anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin e paditësit në punë është e bazuar, për këtë pjesë e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka

vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund të pranojë një qëndrim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nuk është vërtetuar gjendja faktike, për të cilat arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjykimeve të përmendura të gjykatave të instancës më të ulët, prandaj u desh që të dy aktgjykimet të prishen.

Me revizion atakohen aktgjykimet e instancës më të ulët për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, por nuk është theksuar se me çka kanë të bëjnë ato shkelje, ndërsa kjo gjykatë e revizionit vlerëson se nuk ekzistojnë shkelje, sepse sipas dispozitës së nenit 386 të LPK, kjo gjykatë e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në kufinj të arsyeve të cekura në revizion, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet e parashikuara nga neni 354 par.2 pika 11 të LPK përkritazi me aftësinë procedurale të palës dhe përfaqësimit e rregullt të saj, por në rastin konkret shkelje të tilla nuk ekzistojnë.

Për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nuk është vërtetuar gjendja faktike kur gjykata e shkallës së parë ka gjetur se në mes të palëve nuk ekziston kontrata e punës e lidhur në mes të së paditurës si punëdhënëse dhe paditësit si i punësuar, ngase kontrata e cila gjendet në shkresat e lëndës në të cilën si palë kontraktuese janë shënuar palët ndërgjyqëse, e cila në të vërtet nuk është e nënshkruar, por në të cilën janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e palëve nga marrëdhëniet e punës, sepse sipas dispozitës së nenit 9 par.9.3 të Rregullores së UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, Nr.2001/27, është paraparë se punonjësi nënkupton personin fizik të punësuar për të kryer punën ose shërbime për punëdhënësin nën autoritetin ose kontrollin e punëdhënësit. Punonjësi përbush obligimet si dhe ushtron të drejtat e tij në përputhje me ligjin në fuqi, me kontratën e punës, sipas rastit, edhe me marrëveshje kolektive. Nga shkresat e lëndës del se paditësi, nuk e ka nënshkruar kontratën e tillë të punës për shkak të frikës se do t'i zbriten kontributet nga rroga, por nuk është kontestuese se prej 13.06.2000 deri në ditën e marrjes së vendimit të së paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, paditësi ka punuar te e paditura dhe ka realizuar të ardhura nga

marrëdhënia e punës, prandaj parashtrohet pyetja se nëse ekziston kontrata e punës të cilën palët heshtazi e kanë pranuar pa marrë parasysh se nuk e kanë nënshkruar apo nuk ekziston. Në qoftë se nuk ekziston, shtrohet pyetja tjetër se a mund të ekzistojë marrëdhënie juridike e punës në mes të paditësit dhe të paditurës dhe varësisht nga kjo si mund t'i ndërpritet marrëdhënia faktike e punës personit i cili gjendet në marrëdhënie faktike të punës. Në procedurën e shkallës së parë nuk është vërtetuar se përveç kontratës së përmendur me cilin dokument janë paraparë detyrimet e paditësit nga marrëdhënia e punës te e paditura, sepse të paditurit si drejtor teknik në ndërmarrjen e paditur doemos duhet t'i jenë caktuar punët dhe detyrat e punës me kontratë ose me ndonjë akt tjetër normativ, sepse ai në marrëdhënie pune ka të drejta dhe përgjegjësi. Nga fakti se cilat janë detyrimet e paditësit në vendin e punës ku ka qenë i caktuar të punojë varet edhe fakti se ai me sjelljet e veta në punë ka bërë shkelje të detyrës së punës apo jo dhe nën kushtet e caktuar me ligj dhe kontratën e punës mund t'i shqiptohet masa disiplinore apo jo.

Shkëputja e marrëdhënies së punës sipas nenit 11, par.11.1 përveç të tjerash edhe në rastin e paraparë nën (d) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit, sipas nenit 12.2 kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes se keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi, ndërsa me par.11.4 përkufizohet se çka përfshin me përmbushjen e pakënaqshme të detyrave të punës dhe me nennin 11.5 është paraparë se në rastet kur zbatohet neni 11.2: nën a) punëdhënësi do ta njoftojë të punësuarin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës. Ai njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës dhe nën b) punëdhënësi do ta mbajë një takim me punonjësin me ç'rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në rast se punëtori është anëtar i ndonjë sindikate, ka të drejtë që në atë takim të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues i sindikatës.

Nga dispozitat e tilla nuk del se e paditura është e detyruar të zhvillojë procedurë tjetër për shkëputjen e kontratës pos kësaj të paraparë me dispozitat e cekura më parë, prandaj në procedurën e shkallës së parë nuk janë vërtetuar rrethanat që kanë të bëjnë me përshkrimin e detyrave të punës së paditësit në vendin e tij të punës, se a janë plotësuar kushtet e parapara me kontratën e punës përkatësisht me dispozitat e sipërpërmendura të kësaj rregullore të UNMIK-ut,

mënyrën dhe kohën e shkeljes së detyrës së punës, përkatësisht përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, për të cilat arsye nuk mund të shqyrtohet zbatimi i drejtë i së drejtës materiale kur gjykatat e instancës së ulët kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në pjesën që ka të bëjë me vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit dhe kthimin e tij në punë te e paditura.

Gjykata e shkallës së dytë ka qenë e detyruar që sipas detyrës zyrtare të kujdeset për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, por nuk ka vepruar kështu, prandaj kjo gjykatë e revizionit sipas nenit 395 par.2 të LPK, u desh që t'i prishë të dy aktgjykimet e cekura dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që t'i evitohet të metat e sipërpërmendura, me provat e nevojshme t'i vërtetohet të gjitha faktet e përmendura relevante me administrimin e provave të nevojshme e sidomos të administrojë provën me dëgjimin e paditësit dhe drejtorit të ndërmarrjes së paditur në cilësi të palës dhe pas vlerësimit të drejtë të provave të marrë vendim të ligjshëm.

Nga sa u tha më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës me zbatimin e nenit 395 par.2 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.18/2005, më 20.07.2005

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Rifat Zylfiu

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - patundshmëria - anulimi i kontratës - 354 (2) (14) , 356 LPK revizion i aktgjykimit - revizioni i pranuar - urdhërimi i rigjykimit]

Paditësi paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Komunale e Pejës e ka pranuar ankesën e paditësve duke anuluar kontratën e shit-blerjes në mes të paditësve në njërën anë si shitës, dhe të paditurve.

Të paditurve u është urdhëruar që të lirojnë shtëpinë dhe lokalet afariste të paditësit. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës më të ulët kanë kryer shkelje të dispozitave të aplikueshme të procedurës kontestimore në bazë të nenit 354 paragrafit 2 pikës 14 të LPK ngase dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe si i tillë, nuk është i ekzekutueshëm. Gjykatat e shkallës më të ulët nuk kanë përcaktuar qartë se cilat pjesë të pronës duhet të lirohen dhe ti dorëzohen paditësve. Gjykata Supreme ka vendosur se aktgjykimi detyrues doemos duhet të përmbajë vendimin jo vetëm për raportin juridik, por edhe të drejtat dhe detyrat në atë raport. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e bazuar.

Rev.nr.43/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Osman Tmava, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve M.P., Gj.P., F.A. e lindur P., M.T. e lindur P., M.L. e lindur P. dhe N.P. e lindur P., të gjithë nga Vodnja, Republika e Kroacisë, të cilët i përfaqëson Ferid Gjokolli, avokat nga Peja, kundër të paditurve A.K. dhe T.K. e lindur P., me banim të përkohshëm në Zvicër, Z.Sh., J.K. dhe T.K., që të tre nga Peja, të cilët i përfaqëson Bekë Lajçi, avokat nga Peja, për prishjen e kontratës dhe dorëzimin e patundshmërisë, përkritazi me revizionin e të paditurve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.238/2003 datë 18.11.2003 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.537/2001 datë 19.05.2003, në seancën e mbajtur më 28.07.2005, mori këtë

A K T V E N D I M

Pranohet si i bazuar revizioni i të paditurve, prishen aktgjykimi

i Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.238/2003 datë 18.11.2003, dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.537/2001 datë 07.04.2003, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.537/2001 datë 19.05.2003 është pranuar kërkesëpapia e paditësve dhe është shkëputur kontrata mbi shitblerjen e lidhur më datë 21.07.1994, në mes të paditësve: M.P., F.A. e lindur P., M.T. e lindur P., M.L. e lindur P., N.P. e lindur P., të gjithë nga Vodnja, Republika e Kroacisë, në njërën anë si shitës dhe të paditurve A.K. dhe T.K. e lindur P., që të dy nga Peja, tani me banim të përkohshëm në Zvicër, në tjetrën anë si blerës, për shkak të mospërmbushjes së saj nga ana e të paditurve. Me pjesën II të dispozitivit detyrohen të paditurit A.K., T.K. e lindur P., Z.Sh., J.K. dhe T.K., të gjithë nga Peja, që paditësve t'ua lirojnë shtëpinë dhe lokalet afariste të ngritur në ngastrën kadastrale nr.2773 si dhe në ngastrën kadastrale nr.4153 nga fletaposeduese nr.834 kk Pejë, nga personat dhe sendet dhe të njëjtat t'ia dorëzojnë paditësve në posedim, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit në kërcnim të përbarimit të detyrueshëm. Me pjesën III të dispozitivit janë detyruar të paditurit që paditësve t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore solidarisht në shumë prej 1.816 € në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit nën kërcnim të përbarimit të detyrueshëm.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.238/2003 datë 18.11.2003, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurve dhe aktgjykimet e Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.537/2001 datë 07.04.2003 dhe aktgjykimi plotësues C.nr.537/2001 datë 19.05.2003, janë vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.537/2001 datë 19.05.2003 dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, të paditurit me kohë kanë paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë të ndryshohen ashtu që kërkesëpapia e paditësve të refuzohet si e pabazuar ose të dy aktgjykimet të prishen dhe lënda t'i kthehet për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit

të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në procedurën e zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë në mënyrë jo kontestuese janë vërtetuar faktet se paditësit të paditurve A.K. dhe T.K. e lindur P. i kanë shitur patundshmërinë e shënuar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së parë, që është identike me përshkrimin e së njëjtës paluajtshmeri të dhënë në kontratën e lidhur mes palëve më 21.07.1994, e cila patundshmeri gjendet në Pejë, në ish Rr. "APJ" nr.26, që përmbahet prej shtëpisë me bodrum, furrës së bukës dhe dy banesave. Në pikën 2 të kontratës është përcaktuar çmimi kontraktues në lartësi prej 560.000 DM të cilin çmim blerësit do ta paguajnë dhe atë 200.000 DM deri më 31.12.1994, ndërsa pjesën tjetër në lartësi prej 36.000 DM, në afat prej 3 vitesh gjegjësisht deri më 31.12.1997 dhe në pikën 5 të kësaj kontrate është përcaktuar se blerësit hynë në posedim të kësaj patundshmerie menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate. Në mes të ndërgjyqësve në procedurë nuk është kontestues fakti se dy të paditurit e parë u kanë paguar paditësve shumën prej 160.000 DM, ndërsa kanë mbetur pa u paguar edhe 400.000 DM. Po ashtu, nuk është kontestuese në mes të palëve fakti se patundshmërinë lëndore që nga data e përpilimit të kontratës e kanë në posedim dhe shfrytëzim të paditurit A.K. dhe T.K. e lindur P., të cilat lokale afariste ia kanë dhënë me qira të paditurve Z.Sh., J.K. dhe T.K..

Gjykata Supreme e Kosovës thënie e revizionit se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të procedurës kontestimore nga dispozita e nenit 354 par.2 pika 14 të LPK, i ka vlerësuar si të bazuara ngase dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe, si i tillë, nuk është i ekzekutueshëm. Në pjesën II dispozitivi i aktgjykimit nuk është i kuptueshëm sepse nuk mund të kuptohet se cili nga i paditurve cilën pjesë të asaj pasurie duhet të lirojë nga personat dhe sendet dhe t'ia dorëzojë paditësve. Aktgjykimi detyruar doemos duhet të përmbajë vendimin jo vetëm për raportin juridik, por edhe të drejtat dhe detyrat në atë raport. Prandaj, dispozitivi i aktgjykimit duhet që në mënyrë të qartë të përcaktojë çka janë të detyruar të paditurit veç e veç të lirojnë; cilën shtëpi dhe cilat lokale të ngritura në ngastrat kadastrale nr.2772 dhe nr.4153 nga fletaposeduese nr.384 kk Pejë; adresën e shtëpisë, sipërfaqen e saj dhe prej çka përbëhet shtëpia; adresën e lokaleve afariste veç e veç për secilin lokal si dhe sipërfaqen e tyre me

përshkrimin se çka përmbajnë këto lokale. Kjo ngase, sipas kontratës e lidhur më 21.07.1994 në mes Gj.P. nga Vodnja, M.P., F.A., M.T., M.L. dhe N.P. si shitës në një anë dhe A.K. dhe T.K. nga Peja, si blerës në anën tjetër, të nënshkruar nga shitësit e të panëshkruar nga blerësit, por që nuk është kontestuese që është lidhur një kontratë e tillë mbi shitblerjen e patundshmërisë, në pikën 1 të kontratës është shitur patundshmeria në Rr. "APJ" nr.26 e cila përbëhet nga një shtëpi me bodrum, një furrë dhe dy banesa. Aktgjykimi i cili nuk i përmban kushtet e tilla është i pakuptueshëm dhe praktikisht i pa ekzekutueshëm dhe përfaqëson shkeljet thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 354 par.2 pika 14 e LPK, e cila është e natyrës absolute për të cilin shkak aktgjykimi duhet të priset.

Ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje thelbësore të procedurës kontestimore të natyrës absolute për të cilin shkak gjykata e shkallës së dytë ka qenë e detyruar që të kujdeset sipas detyrës zyrtare e nuk është kujdesur edhe aktgjykimi i kësaj gjykate është marrë me shkeljen thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 354 par.1 lidhur me nenin 356 par.2 të LPK, për të cilin shkak aktgjykimi i goditur duhet të priset.

Për shkak të ekzistimit të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë të natyrës absolute, për të cilin shkak medoemos duhet të prishen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, nuk mund të vlerësohet zbatimi i drejtë i së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e cekura më parë, me provat e nevojshme të vërtetojë gjendjen faktike dhe me rastin e marrjes së vendimit merititor në dispozitivin e vendimit në mënyrë të qartë të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqësve, t'i vërtetojë edhe të gjitha faktet tjera vendimtare dhe të marrë vendim të ligjshëm.

Nga sa u tha e me zbatimin e nenit 394 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.43/2004, më 28.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - kompensimi i të ardhurave personale - kthimi në vendin e punës- revizion i aktgjykimit - revizioni i refuzuar]

Paditësi paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Komunale nuk e ka pranuar kërkesën e paditësit për ta urdhëruar të paditurin, që paditësin ta kthej në vendin e punës.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatat e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë dhe të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike, kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale, për shkak se në këtë rast kemi të bëjmë me kontratë provuese prej 3 muajve dhe me kalimin e periudhës provuese, mardhëniet e punës gjithashtu përfundojnë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është pabazuar.

Rev.nr.49/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Osman Tmava, Vjosa Nimani-Zylifu dhe dr.Hamdi Podvorica, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses V.D., nga Prizreni, të cilën e përfaqëson Zef Delhysa, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Banka Amerikane e Kosovës në Prishtinë, për anulimin e vendimit dhe kompensimin e të ardhurave personale, përkitazi me revizionin e paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, Ac.nr.408/2003 datë 27.01.2005, në seancën e mbajtur më 28.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, Ac.nr.408/2003 datë 27.01.2005.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prizren, C.nr.632/2002 datë 16.05.2003, është refuzuar kërkesëpadia e

paditësit që të anulohet si kundërvlefshëm vendimi i të paditurës së datës 13.09.2002 dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 8 ditësh ta kthejë paditësen në vendin e punës i cili i përgjigjet aftësive të saja profesionale me të gjitha të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës si dhe t'ia paguajë shpenzimet procedurale. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia alternative e paditëses që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të dëmshpërblimit t'ia paguajë 5 paga mujore dhe në pjesën III të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta.

Gjykata e Qarkut Prizren me aktgjykimin Ac.nr.408/2003 datë 27.01.2005, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale Prizren, C.nr.632/2002 datë 16.05.2003, e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë në pjesën II të dispozitivit të ndryshohet dhe të pranohet në atë pjesë kërkesëpadia e paditëses ose i njëjti në atë pjesë të prishet dhe shkresat e lëndës t'i kthehen gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja me kontratën për punësim të datës 20.06.2002 ka lidhur kontratën për punësim provues me të paditurën-Bankën Amerikane të Kosovës në Prishtinë dhe, është pajtuar për punën provuese prej tre muajsh duke filluar nga data e paraparë me nenin 3 të kësaj kontrate. Me nenin 31 pika 1 të kontratës, punësimi mund të përfundojë sipas njoftimit me shkrim një muaj përpara dhe pa shkakun e të punësuarit ose të punëdhënësit.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar plotësisht dhe drejtë gjendjen faktike, ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, duke konstatuar se nuk ekzistojnë shkeljet thelbësore të procedurës kontestimore, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara thëniet në revizion, sepse, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në mes palëve është lidhur kontratë punësimi në kohë të caktuar në zgjatje prej tre muajsh, paditësja është pajtuar për punën provuese prej tre muajve duke filluar nga data e paraparë me nenin 3 të kontratës, është pajtuar që në cilën do kohë gjatë kësaj periudhe, punëdhënësi e paditura ose e punësuarapaditësja kanë të drejtë të ndërprejnë punësimin me njoftim të shkruar brenda 24 orëve, pa kurrfarë dëmshpërblimi ose kompensimi, përpos të ardhurave të fituara deri në ditën e përfundimit të punës. Nga kjo del se kontraktuesit në bazë të vullnetit të mirë kanë nënshkruar kontratën e punësimit dhe me këtë nënkuptohet se kanë pranuar edhe kushtet nga kjo kontratë. Prandaj, pala e paditur nuk ka qenë e detyruar të zhvillojë kurrfarë procedure për shuarjen e marrëdhënies së punës, por për shuarjen e një marrëdhënie të tillë të punës mjafton që punëtori të komunikohet me shkrim 1 muaj përpara, pas skadimit të afatit të caktuar për ndërprerjen e kontratës me Bankën Amerikane në Kosovë.

Meqenëse në rastin konkret ka të bëjë me kontratën e punës e lidhur në kohë të caktuar prej tre muajve, me kalimin e afatit të caktuar, shuhet edhe një marrëdhënie e tillë e punës, prandaj drejtë kanë vendosur gjykatat e instancës më të ulët kur kërkesën alternative të paditëses e kanë refuzuar si të pabazuara, pra edhe për të drejtën e pagesës mujore nga marrëdhënia e punës, e cila kërkesë varet nga ekzistimi i marrëdhënies së punës.

Thëniet e tjera në revizion, sipas vlerësimit juridik, janë pa ndikim në marrjen e një vendimi të ligjshëm në këtë çështje juridike.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 393 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.49/2005, më 28.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - anulimi i konkursit për punësim 354 (2) (14) 365, 375 LCP - revizion i aktgjykimit - revizioni i pranuar]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Komunale në Gjilan pjesërisht e ka pranuar ankesën e paditësit duke anuluar konkursin në gazetën e përditshme, duke përfshirë këtu edhe vendimin mbi zgjedhjen e kandidatit F.K në këtë pozitë, duke e obliguar të paditurën të ri-shpall konkursin për këtë pozitë.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatat e shkallës më të ulët kanë kryer shkelje të dispozitave të aplikueshme të procedurës kontestimore në bazë të nenit 354 paragrafit 2 pikë 14 të LPK. Gjykata Supreme ka vendosur se arsyetimi nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare për marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është e bazuar.

Rev.nr.54/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.sc.Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit J.B., nga Gjilani, kundër të paditurës komuna e Gjilanit, për anulimin e konkursit dhe vendimin për zgjedhjen e kandidatit, përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Gjilan, Ac.nr.296/2004 datë 23.12.2004 në seancën e mbajtur më 28.07.2005, mori këtë

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i të paditurës dhe prishen aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Gjilan, Ac.nr.296/2004 datë 23.12.2004 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale Gjilan, C.nr.389/2001 dhe 221/2002 datë 16.09.2004, në pjesën I të dispozitivit, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Në pjesën II të dispozitivit aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komonale Gjilan C.nr.398/2001 dhe C.nr.221/2002 datë 16.09.2004, pjesërisht është pranuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar konkursi i publikuar në të përditshmen “Rilindja” të datës 23 maj 2001, për vendin e punës zyrtar për siguri me komunitete dhe vendimi mbi zgjedhjen e kandidatit F.K. dhe detyrohet e paditura që për këtë vend pune të shpallë konkurs të ri në afat prej 8 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi. Me pjesën II të dispozitivit për tepricën e kërkesë padisë të paditësit që të anulohet konkursi i shpallur në të përditshmen “Rilindja” më datë 23 maj 2001, për vendin e punës asistent teknik dhe personel i sigurimit si dhe të anulohet konkursi intern i datës 25.03.2002, për vendet e punës inkasat të detyrueshëm, asistent teknik, sekretar teknik, zyrtar për regjistrim dhe mirëmbajtje të banesave dhe asistent për mirëmbajtjen e banesave si dhe të anulohen vendimet mbi zgjedhjen e kandidatëve në këto vende të punës dhe të bëhet zgjedhja e paditësit në njërin prej këtyre vendeve të punës është refuzuar si e pabazuar dhe me pjesën III të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Qarkut Gjilan me aktgjykimin Ac.nr.296/2004 datë 23.12.2004, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe të paditurës dhe aktgjykimin e Gjykatës Komonale Gjilan e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë në pjesën I të dispozitivit të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se e paditura ka shpallur konkurs në të përditshmen “Rilindja” më datë 23.05.2001 për vendin e punës zyrtar për siguri dhe komunitete, për të cilin vend kandidati duhet të ketë shkollën e mesme, njohuri në punë me kompjuter dhe njohjen e gjuhës serbokroate. Në konkursin e shpallur është pranuar kandidati F.K.. Paditësi ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, posedon certifikatën mbi njohjen e gjuhës shqipe dhe serbokroate për grupin e dytë si dhe përvojë pune në komunë, ndërsa kandidati i pranuar ka të kryer shkollën e mesme ekonomike.

Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se, siç theksohet në arsyetimin e aktgjykimit të goditur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar për vendin e punës zyrtar për siguri me komunitete i publikuar në të përditshmen “Rilindja” më datë 23 maj 2001, sipas të cilit është kërkuar që kandidati të ketë shkollën e mesme, njohurinë me punët në kompjuter dhe njohjen e gjuhës serbokroate. Sipas këtij konkursi është pranuar kandidati F.K. i cili në dosjen e punës ka pasur vetëm diplomën mbi kryerjen e shkollës së mesme ekonomike, ndërsa paditësi e ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, posedon certifikatën mbi njohjen e gjuhës shqipe dhe serbokroate për grupin e dytë si dhe përvojën e punës në komunë, ndërsa të njëjtit i mungon dëshmia për njohurinë e punës në kompjuter dhe përfundon se paditësi për këtë vend pune i ka plotësuar kushtet më mirë se kandidati i pranuar.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, prandaj ka vendosur si në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të goditur.

Gjykata e Qarkut në Gjilan në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia është pjesërisht e bazuar e që ka të bëjë për vendin e punës zyrtar për siguri me komunitete e publikuar në të përditshmen “Rilindja” më 23 maj 2001.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund të pranojë një konkludim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 354 par.2 pika 14 të LPK, për të cilën arsye është dashur të prishet.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore konsistojnë në faktet se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, se arsyetimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kundërthënëse. Kjo ngase, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të goditur edhe pse konstaton se: “kushtet e paraqitura në konkurse për pranimin e punëtorëve në organet komunale të administratës patjetër duhet të jetë në pajtim me kushtet e përcaktuara me aktin mbi organizimin e brendshëm të organit të administratës, ndërsa në rastin konkret nuk është mundur të konstatohet se këto kushte janë në harmoni me aktin e përgjithshëm mbi organizimin e brendshëm sepse i njëjti nuk është prezantuar si provë”, e anulon konkursin e publikuar në të përditshmen “Rilindja” të datës 23.05.2001, për vendin e punës zyrtar për siguri me komunitete dhe vendimin për zgjedhjen e kandidatit F.K. dhe e obligon të paditurën komunën e Gjilanit-Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë për këtë vend të shpallë konkurs të ri.

Në bazë të gjendjes së këtyre faktike, gjykata e shkallës së parë edhe pse konkludon se kandidati i pranuar nuk i ka plotësuar kushtet nga konkursi i lartpërmendur por, përveç që e anulon vendimin për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës zyrtar për siguri me komunitete, e anulon edhe konkursin për plotësimin e vendit të punës së lartpërmendur, pa e vërtetuar faktin vendimtar se, kandidati i pranuar a i ka plotësuar kushtet e shpalljes dhe a ka qenë shpallja në pajtim me rregulloren për sistematizimi e punëve dhe detyrimeve të punës të së paditurës.

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit, që ka të bëjë me shkelje thelbësore të procedurës kontestimore parashikuar nga neni 354 par.2 pika 14 i LPK. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë gjithashtu është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore parashikuar nga neni 354 par.2 pika 14 lidhur me nenin 365 par.2 dhe 375 të LPK, ngase, arsyetimi i aktgjykimit të goditur nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare për marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe për thëniet ankimore të paditurës, gjykata e shkallës së dytë nuk është kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të natyrës absolute, të cilat i përmban aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë,

edhe pse sipas dispozitës së përmendur të nenit 365 par.2 të LPK ka qenë e detyruar të veprojë sipas kësaj dispozite, për të cilin shkak aktgjykimi i goditur duhet doemos të prishet.

Për shkak të shkeljeve të lartpërmendura të procedurës kontestimore nuk është e mundur të vlerësohet zbatimi i drejtë i të drejtës materiale.

Në pjesën II të dispozitivit aktgjykimi nuk është goditur me ankesë, prandaj në këtë pjesë ka mbetur i pashqyrtuar.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim të mënjanojë të metat e lartpërmendura, me prova të nevojshme të vërtetojë të gjitha faktet vendimtare dhe pas vlerësimit të drejtë të provave të marrë vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 394 par.1 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.54/2004, më 28.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - shpërblimi i demit jomaterial - 200 (1) (2) Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore - revizion i aktgjykimit - revizioni pjesërisht i pranuar]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka pranuar ankesën e paditësve duke e obliguar të paditurin që të kompenzoj paditësin për dëmin jomaterial.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatat e shkallës më të ulët kanë zbatuar drejtë ligjin duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve trupore, të cilat i kanë pësuar paditësit dhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve, duke zbatuar drejt dispozitën e nenit 200 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (LMD). Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatat e shkallës më të ulët kanë kryer shkelje të dispozitave të aplikueshme të procedurës kontestimore, për shkak të eksistimit të kundërtënieve në mes të arsytimit të dhënë dhe provave, parashikuar nga neni 354 paragrafi 2 pika 14 të LPK. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është pjesërisht e bazuar.

Rev.nr.59/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, mr.sc.Rifat Zylfiu, Shahdane Agani, Meleqe Behxheti, Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve S., A. dhe S.K., të gjithë nga fshati Slllovi, të cilët i përfaqëson Zaim Istrefi, avokat nga Prishtina, kundër së paditurës kompania e sigurimeve “Insig” në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari Nysret Mjeku, për dëmshpërblim, përkitazi me revizionin e së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.63/2003 datë 08.12.2003, në seancën e mbajtur më 26.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET revizioni i së paditurës i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.63/2003 datë 08.12.2003, për aq sa ka të bëjë me detyrimin e së paditurës që paditësve t'ua shpërblejë dëmin jomaterial, ndërkaq po ky revizion PRANOHET dhe PRISHEN pjesët e aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.63/2003 datë 08.12.2003 dhe aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan Ac.nr.63/2003 datë 08.12.2003, për aq sa kanë të bëjnë me detyrimin e së paditurës që paditësit S.K. t'ia shpërblejë dëmin material.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prishtinë, me aktgjykimin Ac.nr.63/2003 datë 08.12.2003, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e së paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale Lipjan, C.nr.184/2002 datë 12.11.2002, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësve dhe është detyruar e paditura që, në emër të shpërblimit të demit jomaterial për lëndimet e pësuar trupore t'ua paguajë si më poshtë: paditësit S.K., në emër të dhembjeve fizike, shumën prej 500 € dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 500 €; paditëseve A.K. dhe S.K., secilës veç e veç, për dhembjet fizike shumën prej 1.000 €, për frikën e përjetuar shumën prej 1.000 €; paditësit S.K., për dëmin material si pasojë e dëmtimit të veturës shumën prej 780,90 € dhe të gjithë paditësve, në emër të shpërblimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, shumën prej 952 €.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura ka paraqitur me kohë revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme t'i prishë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.380/2003 datë 08.12.2003 dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale Lipjan, C.nr.118/2003 datë 04.06.2003, kurse çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme pasi që, në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e shqyrtoi aktgjykimin e goditur, shkresat e lëndës dhe thëniet në revizion, gjeti se revizioni nuk është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më 13.07.2004, në rrugën

lokale Lipjan-Sillovi është shkaktuar një aksident trafiku, duke u përplasur vetura e markës “Audi 80” me targa 165-KS-394, të cilën e drejtonte paditësi S.K., me veturën e markës “Pollo”, me targa 281-KS-830, të cilën e drejtonte B.D., nga fshati Gadime e Epërme. Në këtë aksident kanë pësuar lëndime të lehta trupore paditësit S.K., A.K. dhe S.K. dhe është dëmtuar vetura, të cilën e drejtonte paditësi S.K.. Aksidenti, sipas vlerësimit të ekspertëve të komunikacionit, Arif Krasniqi, inxhi. dip. kom. dhe Yll Koshi, inxhi. dip. kom, është shkaktuar për fajin dhe me kontributin e përbashkët të dy shoferëve të automjeteve të cituara më lart. Në momentin e shkakimit të aksidentit, vetura të cilën e drejtonte paditësi S.K. ka qenë e siguruar nga përgjegjësitë ndaj palëve të treta tek e paditura.

Duke u nisur nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë përfundimin se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur në procedurën ankimore se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, i ka zbatuar drejtë dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, se arsyetimi i aktgjykimit përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe gjykata ankimore, prandaj e ka refuzuar si të pabazuara ankesën dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Për sa i përket detyrimit të së paditurës që paditësve t’ua shpërblejë dëmin jomaterial, Gjykata Supreme i vlerësoi si të pabazuara thëniet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase nuk ceket asnjë dispozitë konkrete e LPK e cila të jetë shkelur dhe, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kjo pjesë e aktgjykimit të goditur nuk është e përfshirë me shkelje të tilla të cilat kjo Gjykatë i vëren kryesisht.

Thëniet e revizionit se pjesët e aktgjykimeve të sipërpërmendura të gjykatave të instancës më të ulët me të cilat është vendosur për shpërblimin e dëmit jo material, janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës shihet se me kontratën e shitblerjes së automjetit nr.141/202, datë 12.06.2002, paditësi S.K. e kishte blerë nga Ali Sylejmani veturën me të cilën paditësve u është shkaktuar dëmi, por

kjo veturë edhe më tej ka mbetur e regjistruar me lejen e qarkullimit VRD.0249217, në pronësi të shitësit. Kontrata për sigurimin e këtij automjeti për përgjegjësitë ndaj palëve të treta ka qenë e vlefshme dhe mjetet e paguara për këtë sigurim, në momentin e shkakimit të dëmit i ka shfrytëzuar e paditura. Me Rregulloren e BPK-ës për sigurimin e detyrueshëm të automjeteve nga përgjegjësia ndaj palëve të treta, (dispozita e nenit 1.4) parashikohet se sigurimi motorik mbulon policëmbajtësin e automjetit dhe çdo person tjetër që me lejen e policëmbajtësit përdor automjetin ose që jep lejen që automjeti të përdoret. Ditën e ngjarjes paditësi e ka përdorur automjetin me lejen e policëmbajtësit. Nga sa u tha, janë të pabazuara thëniet e revizionit se gjykatat e instancës më të ulët i kanë zbatuar gabimisht dispozitat e udhëzimit administrativ nr.2/2001, datë 29.06.2001, dispozitën e parashikuar me nenin 1.5 të Rreg. të BPK, datë 05.10.2001. Gjykata, me rastin e caktimit të masës së dëmit jomaterial, nuk e ka kaluar kufirin e caktuar me Udhëzimin e UNMIK-ut 2001/2, ku janë parashikuar shumat minimale të sigurimit të detyrueshëm.

Gjykatat e instancës më të ulët, duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve trupore, të cilat i kanë pësuar paditësit dhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve, duke zbatuar drejt dispozitën e nenit 200 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (LMD), e kanë caktuar drejtë masën e dëmit jomaterial, kurse shumat e caktuara paraqesin shpagim që shërben për qëllimin e shpërblimit të dëmit të këtij lloji.

Për sa i përket detyrimit të së paditurës që paditësit t’ia shpërblejë dëmin material për dëmtimin e veturës, Gjykata Supreme, tani për tani nuk mund ta pranojë qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët, sepse kjo pjesë e aktgjykimit është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 354 par.2 pika 14. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ekziston kundërthënie ndërmjet asaj që thuhet në shkresat e lëndës dhe asaj që është thënë në arsyetimin e aktgjykimit. Aksidenti, sipas vlerësimit të ekspertëve të komunikacionit Arif Krasniqi, inxhi. dip. kom. dhe Yll Koshi, inxhi. dip. kom, është shkaktuar për fajin dhe me kontributin e përbashkët të të dy drejtuesve të automjeteve të cituara më lart, por, siç thuhet në mendimin e ekspertëve, "lëshimet solidare të dorës së parë janë të shoferit të Audi 80". Gjykatat e instancës më të ulët, duke zbatuar dispozitat e nenit 205 të LMD lidhur me nenin 192 të të njëjtit Ligj, shpërblimin e dëmit e kanë gjykuar mbi bazën e

përgjegjësisë së ndarë, duke llogaritur këtë përgjegjësi në përpjesëtimin 50% në anën e secilit drejtues.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, sipas nenit 365 par.2 të LPK, ka qenë e detyruar që, sipas detyrës zyrtare, t'i vërë re shkeljet e cekura thelbësore të procedurës kontestimore. Meqë nuk ka vepruar sipas kësaj dispozite, aktgjykimi i shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuar nga neni 354 par.1 lidhur me nenin 365 par.2 të LPK.

Gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanojë në rigjykim të metat e vërejtura në këtë aktgjykim dhe pastaj të marrë një vendim të ligjshëm.

Nga sa u tha më lart dhe me zbatimin e nenit 393 dhe 394 par.1 të LPK, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.59/2004, më 26.07.2005

Kryetarja e kolegjit,
Vjosa Nimani-Zylfiu

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - kompenzimi i të ardhurave personale - revizion i aktgjykimit - revizioni i refuzuar Rregulloja e UNMIK-ut 2001/27]

Paditësit paraqitën kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë nuk e ka pranuar kërkesën e paditësve për ta urdhëruar të paditurin që paditësve t'iu kompensoj për të ardhurat personale.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatat e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale, për shkak se themelimi i mardhënies së punës është bërë në bazë të konkursit të pozitës i cili përcakton kriteret e punësimit. Gjykata Supreme ka vendosur se themelimi i mardhënies së punës është bërë në bazë të konkursit, intervistës, të parashikuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27 mbi Themelimin e Marrëdhënies së Punës. Gjykata Supreme ka vendosur se pagesa e të ardhurave personale u takon paditësve prej momentit të themelimit të marrëdhënies së punës, ndërsa për periudhën kontestuese, ata nuk i kanë plotësuar kushtet e lartpërmendura, gjegjësisht themelimi i marrëdhënies së punës nuk ka ekzistuar Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësve është pabazuar.

Rev.nr.70/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr. Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe dr. Hamdi Podvorica, anëtarë, në çështjen juridiket të paditësve A.F., M.M. dhe H.H., të gjithë nga Vushtrria, të cilët i përfaqëson paditësi i parë A.F., kundër të paditurës komuna e Vushtrrisë, për pagesën e të ardhurave personale, përkitazi me revizionin e paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ac.nr.126/2001 datë 30.12.2004, në seancën e mbajtur më 28.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ac.nr.126/2001 datë 30.12.2004.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ac.nr.126/2001 datë 30.12.2004, është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Vushtri, K.nr.64/2001 datë 27.06.2001, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve që të detyrohet e paditura që paditësve t'u paguajë në emër të ardhurave personale për paditësin e parë shumë prej 9.065 DM, për paditësin e dytë shumë prej 6.919 DM dhe për paditësin e tretë shumë prej 4.302 DM të gjithëve për periudhën kohore prej datës 01.09.1999 deri më 31.03.2001 me kamatë ligjore prej 2% duke filluar nga data 27.06.2001 deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 10 DM.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësit me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të kthehet për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të LPK, ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësve u është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimet që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa me pjesën III të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Vushtri, K.nr.76/2000 datë 03.07.2000, i cili ka marrë formën e prerë, është detyruar e paditura që paditësit t'i kthejë në vendet e tyre të punës ose në punët e tjera të cilat u përgjigjen përgatitjeve profesionale me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, por nuk është vërtetuar që ka ekzistuar marrëdhënia e punës së paditësve tek e paditura ndërsa pjesa për anulimin e aktvendimeve (nuk janë cekur numrat dhe datat) si dhe për kompensimin e të ardhurave personale, aktgjykimi është prishur dhe lënda është kthyer për rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se kërkesëpadia e

paditësve është e bazuar, duke detyruar të paditurën që paditësve t'ua paguajë shumat e cekura si në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, në bazë të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe me zbatimin e nenit 373 par.1 pika 3 dhe 4 e kanë ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, kur është konkluduar se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar, sepse themelimi i marrëdhënies së punës bëhet në bazë të konkursit me plotësimin e kushteve për marrëdhëniet e punës, respektivisht marrëdhënia e punës themelohet në bazë të konkurseve, intervistave dhe në bazë të Rregullores për Themelimin e Marrëdhënies së Punës. Në rastin konkret, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, paditësve pagesa e të ardhurave personale u takon prej momentit të themelimit të marrëdhënies së punës, ndërsa për periudhën kontestuese, ata nuk i kanë plotësuar kushtet e lartpërmendura, gjegjësisht themelimi i marrëdhënies së punës nuk ka ekzistuar.

Sipas nenit 386 të LPK, gjykata e revizionit bënë ekzaminimin e aktgjykimit të kundërshtuar, vetëm në atë pjesë në të cilën ai kundërshtohet me revizion dhe, në kuadrin e arsyeve të theksuara në revizion. Thëniet e revizionit e paditësve që “aktgjykimi i gjykatës së qarkut është përfshirë me shkelje të dispozitave materiale pasi që në arsyetim fare nuk është dhënë bazueshmëria e këtij aktgjykimi”, janë të pabazuara, sepse revizioni nuk përmban arsye për të cilat shkelje dhe për bazueshmërinë e aktgjykimit siç ceket në revizion, ashtu që sipas mendimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 354 të LPK, prandaj janë të pabazuara thëniet në revizion që ai është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave, sepse në revizion nuk janë cekur ku

qëndrojnë ato shkelje, ndërsa kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare vetëm shkeljet thelbësore nga neni 354 par.2 pika 10 të LPK.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 393 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.70/2005, më 28.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - ndryshim i vendit të punës- revizioni i pranuar]

I padituri paraqiti kërkesë për revision ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka pranuar ankesën e paditësit dhe ka obliguar të paditurin ta kthejë paditësen në vendin e saj të mëparshëm të punës.

Gjykata Supreme ka vendosur se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabimisht ligjin, dhe ka vlerësuar gabimisht situatën faktike. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është e bazuar.

Rev.nr.91/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Riftar Zylfiu, Shahdane Agani, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Dr.Hamdi Podvorica, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Sh.B. nga Prishtina të cilën e përfaqëson Ali Qosaj avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ndërmarrje Publike Banësore Prishtinë, për anulimin e vendimit për ndërrimin e vendit të punës, përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.248/2002 datë 24.08.2004, në seancën e mbajtur më 26.07.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i së paditurës dhe prishen aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.248/2002 datë 24.08.2004 dhe ai i Gjykatës Komunale Prishtinë C.nr.421/2001 datë 01.03.2002, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.248/2002 datë 24.08.2004, është refuzuar si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale

Prishtinë C.nr.421/2001 datë 01.03.2002, me të cilin është pranuar kërkesëpadia e paditëses si e bazuar dhe është anuluar si jo ligjor vendimi i së paditurës nr.01-933/1 datë 04.07.2000, është detyruar e paditura që paditësen ta kthejë në punët dhe detyrat e punëve të punëtores në bufe, t'ia kompensojë ndryshimin e të ardhurave personale nga data 01.07.2000 deri më datën 31.01.2002, në shumën prej 1.551 €, me kamatë ligjore si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 457 €, të gjitha në afat prej 8 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të LPK, ka gjetur se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja më 06.11.1981 ka themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pacaktuar në punët dhe detyrat punuese-pastruese. Me vendimin të datës 07.11.1984 është sistemuar në vendin e punës-punëtoreshërbyese në bufe, në të cilin vend ka punuar gjer më 04.07.2000. Me vendimin nr.01-933/1 datë 04.07.2000 mbi caktimin e përkohshëm të punëtorëve, paditësja është caktuar në punët dhe detyrat e punës-pastruese gjer më 31.12.2000. Paditësja kundër vendimit mbi ndërrimin e vendit të punës ka paraqitur kundërshtim i cili me vendimin e së paditurës nr.01-1109/1 datë 24.07.2000 është refuzuar si i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, ka gjetur se vendimi i së paditurës nr.01-933/1 të datës 04.07.2000, për caktimin e përkohshëm të paditëses në punët e pastrueses, nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë ligjore, e as në aktin vetëqeverisës të të paditurës, prandaj ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e së paditurës dhe aktgjykimin e shkallës së parë ka vërtetuar, me arsyetimin që gjykata e

shkallës së parë ka vërtetuar se procedura e marrjes së vendimit kontestues për ndërrimin e vendit të punës së paditëses nuk është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 28 par.2 dhe par.3 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të Kosovës.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë një qëndrim të tillë të gjykatave të instancës më të ulët, nga se për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, kjo për arsye se paditësja me vendimin e së paditurës të datës 02.11.1981 është pranuar në vendin e punës pastruese gjer në vitin 1984, kur është sistemuar si punëtoreshërbyese në bufe gjer në muajin qershor të vitit 2000, kur është sistemuar përkohësisht respektivisht gjer më 31.12.2000 në punët dhe detyrat e punës pastruese, por në shkresat e lëndës gjendet një kontratë mbi punën nr.01-2146/1 të datës 11.09.2001, prej së cilës del se paditësja ka nënshkruar kontratën për themelimin për marrëdhënie pune në kohëzgjatje prej 6 muajsh duke filluar prej 10.09.2001 gjer më 10.03.2002, në vendin e punës pastruese, për këto arsye gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar të vërtetojë këtë rrethanë, sepse aktgjykimi nuk përmban arsye lidhur me kontratën mbi punën.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e sipër përmendura, të vërtetojë arsyen e nënshkrimit të kontratës mbi punën në vendin e punës-pastruese nga ana e paditëses, faktin që paditësja që nga fillimi respektivisht të vitit 1981 është pranuar në vendin e punës pastruese, përgatitja profesionale që është parashikuar për vendin e punës në bufe sipas Rregullores të përkohshme mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, t'i vërtetojë të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje, duke pasur parasysh nenin 28 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës dhe, pas vlerësimit të drejtë të gjitha provave të nevojshme, të marrë vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 395 par.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.91/2005, më 26.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procëduren Civile - përcaktimi i pronësisë - Neni 366 LPK - revizion i aktgjykimit kërkesa pranohet]

Paditësi paraqiti kërkesë për revision të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Prizren ka refuzuar kërkesën e paditësit për përcaktimin e pronësinë mbi parcelat kadastrale.

Gjykata Supreme ka vendosur se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabimisht ligjin, dhe ka vlerësuar gabimisht situatën faktike. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së dytë ka aplikuar gabimisht ligjin mbi procedurën kontestimore kur e ka refuzuar ankesën e paditësit të jashtë afatshme, sipas Nenin 366 paragrafi 1 të LPK. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e bazuar.

Rev.nr.112/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylfiu, Shahdane Agani, Vjosa Nimani-Zylifu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M.R. nga fshati Duhël të cilin e përfaqëson Bajram Hamitaga, nga Suhareka, kundër të paditurave Komuna e Suharekës dhe NBI "Suhareka" në Suharekë, për vërtetimin e pronësisë përkritazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut Prizren Ac.nr.259/2001 datë 19.11.2001, në seancën e mbajtur më 20.07.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditësit dhe prishet aktvendimi i Gjykatës së Qarkut Prizren Ac.nr.259/2001 datë 19.11.2002, kurse lënda i kthehet së njëjtës gjykatë për të vendosur lidhur me ankesën e paditësit në procedurën ankimore.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut Prizren Ac.nr.259/2001 datë 19.11.2002, është hedhur poshtë si e pasafatshme ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Suharekë C.nr.90/2001 datë 26.09.2001, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, që të vërtetohet se ai është pronar i parcelave kadastrale e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.90/2001 datë 26.09.2001.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë të prishet dhe lënda t'i kthehet së njëjtës gjykatë për të vendosur lidhur me ankesën.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 386 lidhur me nenin 400 par.4 të LPK, gjeti se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Suharekë C.nr.90/2001 datë 26.09.2001. Gjykata e Qarkut Prizren ka gjetur se ankesa e paditësit është e pasafatshme dhe sipas nenit 366 par.1 të LPK, e ka hedhur poshtë atë si të tillë.

Në arsyetimin e aktvendimit të goditur thuhet se paditësi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka pranuar më 19.10.2001, kurse ankesën kundër këtij aktgjykimi e ka paraqitur më 06.11.2001, me dërgesë të porositur.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, gjykata e shkallës së dytë ka konkluduar se ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë është paraqitur pas afatit prej 15 ditësh dhe me zbatimin e dispozitës së nenit 366 par.1 të LPK, ankesa e paditësit është hedhur si e pasafatshme.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se konkludimi i gjykatës së shkallës së dytë është i paqëndrueshëm juridikisht, sepse nga shkresat e lëndës del se paditësi ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur më 02.11.2002 me dërgesë të porositur R.nr.502, siç del nga vërtetimi mbi pranimin e dërgesave, e jo siç ceket në arsyetimin e aktvendimit më 06.11.2002.

Gjykata Supreme e Kosovës thënie e revizionit se aktvendimi i goditur është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike i vlerësoi si të bazuara, nga se, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 366 par.1 të LPK, kur e ka hedhur poshtë si të pasafatshme ankesën, me çka gabimisht është zbatuar e drejta materiale, e cila ka qenë me ndikim në marrjen e një aktvendimi të ligjshëm, për të cilin shkak aktvendimi i goditur është prishur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së dytë për të vendosur sipas ankesës të paditësit.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 383 lidhur me nenin 400 par.4 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.112/2005, më 20.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Procedurën Civile - ekzistimi i marrëdhënies së punës - Neni 10 Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 Ligji Themelor i Punës revision i aktgjykimit kërkesa refuzohet]

Paditësi paraqiti kërkesë për revision të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Prizren ka refuzuar kërkesën e paditësit për përcaktimin e ekzistimit të marrëdhënies së punës në fabrikën e të paditurit.

Gjykata Supreme ka vendosur se marrëdhëniet e punës ndërmjet paditësit dhe të paditurit pas përfundimit të kontratës nuk parashohin faktin e zgjatjes së marrëdhënies së punës, siq është paraparë me Nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë. Gjykata Supreme ka vendosur se kontrata e paditësit në fabrikën e të paditurit ishte për periudhë të caktuar kohore. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e pabazuar.

Rev.nr.115/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B.G., nga fshati Përqevë, komuna e Klinës, të cilin e përfaqëson Xhafer Maloku, avokat nga Klina, kundër të paditurës NIT "Mirusha" në Klinë, për vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies së punës, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.19/2003 datë 07.04.2005, në seancën e mbajtur më 28.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.19/2003 datë 07.04.2005.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.19/2003 datë 07.04.2005, është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Klinë, C.nr.22/2002 datë 01.10.2002, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit që të vërtetohet se ai është në marrëdhënie të punës tek e paditura në punën dhe detyrat e punës të rojtarit në Fabrikën e Elementeve të Betonit, në Vollujakë dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së aktgjykimit, të sistematizojë në vendin e tij të mëparshëm të punës ose ta përcaktojë ndonjë vend tjetër të punës që i përgjigjet kualifikimit të tij si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 150€.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të ndryshohet ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të LPK, ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi te e paditura ka punuar në bazë të kontratës mbi punën në kohë të caktuar dhe atë sipas kontratës mbi veprën NR.163/3 të datës 08.09.2000, paditësi si kryes i punimeve e ka lidhur kontratën me të paditurin si porositës i punimeve në mënyrë që paditësi t'i kryejë punët dhe detyrat e punës së rojtarit te e paditura në kohë të caktuar duke filluar që nga data 04.08 deri më 4.09.1999. Po ashtu është lidhur kontrata mbi veprën nr.163/2 më datë 08.09.2000, në mes të paditësit si kryes i punimeve me të paditurën si porositës i punimeve, në atë mënyrë që paditësi është detyruar të kryejë punët dhe detyrat e punës të rojtarit te e paditura, në kohë të caktuar duke filluar që nga data 11.10. deri më 11.11.1999. Me këto kontrata është caktuar edhe lartësia mbi kryerjen e punëve.

Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, duke vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune të rregullt te e paditura, i caktuar në punë dhe detyrat e punës së rojtarit në Fabrikën e Elementeve të Betonit në Volljak dhe është detyruar të paditurën që në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi paditësin ta sistematizojë në vendin e tij të mëparshëm të

punës ose, nëse kjo nuk është e mundur, ta sistematizojë në ndonjë vend tjetër pune i cili i përgjigjet kushteve kualifikuese të tij si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës gjyqësore në lartësi prej 150€.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, në bazë të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe me zbatimin e nenit 373 par.1 pika 3 dhe 4 e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, kur është konkluduar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, sepse themelimi i marrëdhënies së punës bëhet në bazë të konkursit me plotësimin e kushteve për marrëdhëniet e punës, respektivisht marrëdhënia e punës themelohet në bazë të konkurseve, intervistave dhe në bazë të Rregullores për Themelimin e Marrëdhënies së Punës. Në rastin konkret, mes ndërgjyqësve është lidhur kontratë pune në kohë të caktuar, me kohëzgjatje prej 04.08. deri më 04.09.1999 dhe prej datës 11.10. deri më 11.11.1999, prandaj dalja në punë të paditësit pas skadimit të kontratës nuk do të thotë që paditësi ka themeluar marrëdhënien e punës, ngase edhe me dispozitën e nenit 10 të Rregullores të lartpërmendur, është paraparë mënyra e themelimit të marrëdhënies së punës e në rastin konkret, marrëdhënia e punës e paditësit te e paditura është themeluar në kohë të caktuar.

Prandaj, sipas mendimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 393 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.115/2005, më 28.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Procëduren Civile - kthim në vendin e punës - kolegji disiplinor - Neni 75 Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës revizion i aktgjykimit kërkesa pranohet]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Komunale në Gjakovë e ka detyruar të paditurin ta kthejë paditësin në vendin e tij të punës si Operator i Makinës së Bluarjes, dhe t'i'a kompenzoj atij shpenzimet procedurale.

Gjykata Supreme ka vendosur se nëse një punëtor mungon në vendin e punës pa arësytim më shumë se 5 ditë me radhë, kontrata e tij shkëputët, sipas nenit 75 paragraf 2 pika 3 të Ligjit Themelor të Punës. Gjykata Supreme ka vendosur se duke pasur parasysh se paditësi nuk është paraqitur në punë prej 01.05.2000 deri 25.01.2002, për arsye të çkafit është ndërmarrë procedurë disiplinore dhe është shqiptuar masa disiplinore të shkëputjes së kontratës me paditësin. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e bazuar.

Rev.nr.117/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylfiu, Shahdane Agani, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Dr.Hamdi Podvorica, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit S.Q. nga Gjakova të cilin e përfaqëson Agim Haraqia avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Industria e materialit ndërtimor në Gjakovë, për anulimin e vendimit dhe kthimin në punë, përkritazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac.nr.239/2004 datë 25.01.2005, në seancën e mbajtur më 26.07.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet revizioni i së paditurës dhe NDRYSHOHEN aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac.nr.239/2004 datë 25.01.2005 dhe ai i Gjykatës Komunale Gjakovë C.nr.545/2003 datë 22.04.2004, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, që të prishet vendimi i komisionit disiplinor i të paditurës nr.214-3 datë 24.08.2000, me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës nga data 01.01.2000 dhe që të detyrohet e paditura që atë ta kthejë në vendin e punës, frezaq-tornitor, si dhe që të paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 505 €.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale Gjakovë C.nr.545/2003 datë 22.04.2004, është pranuar kërkesëpadia e paditësit, është prishur vendimi i komisionit disiplinor i të paditurës nr.214-3 datë 24.08.2000 me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës nga data 01.01.2000 dhe është detyruar e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës frezaq-tornitor, si dhe t'i'a kompenzojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 505 €, në afat prej 15 ditësh.

Gjykata e Qarkut në Pejë me aktgjykimin Ac.nr.239/2004 datë 25.01.2005 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale Gjakovë e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar, ose ato të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të LPK, ka gjetur se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura nga 02.05.1972 e gjer më 19.12.1999. Gjatë asaj periudhe ka punuar punë të ndryshme, por kohët e fundit si tornitor. Në nëntor të vitit 1999, për shkak të kërcënimeve nga ana e disa personave të panjohur, lidhur me punën e kryer gjatë kohës së luftës në Kosovë,

paditësi i frikësuar dhe me lejen e shefit H.D. ka pushuar disa ditë dhe pas 2 jave është paraqitur në punë, por përsëri me lejen e shefit ka vazhduar të pushojë, ashtu ka vepruar edhe pas 1 muaji, ndërsa nga data 01.05.2000 e gjer më 25.01.2002, nuk është paraqitur në punë.

Në bazë të kësaj gjendjeje të çështjes gjykata e shkallës së parë është e mendimit që paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë me lëshimin e të paditurës, për arsye se nuk i ka lëshuar vendim për pushim me pagesë dhe për shkak të mos dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në shqyrtimin për procedurën disiplinore, në të cilin atij i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje të marrëdhënies së punës, për shkak të mungesës më shumë se 7 ditë nga puna, prandaj sipas vlerësimit të saj qëndron detyrimi i së paditurës që paditësin ta kthejë në vendin e punës në të cilin ka punuar.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë gjendjen faktike të vërtetuar në bazë të provave të administruara, ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, qëndrimi juridik i të dy gjykatave më të ulëta paraqet zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për arsye se nga vet fakti që paditësi për periudhën kohore prej 01.05.2000 e gjerë më 25.01.2002, nuk është paraqitur fare në punë, tek e paditura e cila rrethanë nuk është kontestuese mes palëve, gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë konstatuar kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. E paditura drejtë e ka zbatuar dispozitën e nenit 75 par.2 pika 3 të Ligjit Themelor të Drejtave nga Marrëdhënia e Punës i cili është në fuqi, me të cilin parashikohet që punëtorit i ndërprehet marrëdhënia e punës nëse pa arsye mungon nga puna 5 ditë pa ndërpre, në rastin konkret paditësi nuk është paraqitur në punë prej 01.05.2000 gjerë më 25.01.2002, për të cilën arsye edhe është zhvilluar procedura disiplinore me të cilën paditësit i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës.

Në shkresat e lëndës ekzistojnë provat prej të cilave vërtetohet se paditësi nuk ka qenë në adresë të caktuar, ashtu që adresa e paditësit ka qenë e panjohur, për t'ia dërguar ftesën për procedurën disiplinore. Fakti relevant dhe i pakontestueshëm është që paditësi nuk është paraqitur në punë tek e paditura në periudhën e lartpërmendur, ashtu që sipas vlerësimit të kësaj gjykate, të dy gjykatat gabimisht kanë zbatuar

të drejtën materiale, me pranimin e kërkesëpadsisë të paditësit si e bazuar, ashtu që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë ndryshuar dhe kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pabazuar.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 395 par.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.117/2005, më 26.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Procëduren Civile - kompenzim i dëmit - konflikt kompetencash - Neni 354 (2) (8) (16) LPK- Neni 1, 3.1 Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47, revizion i aktgjykimit - kërkesa pranohet]

Paditësi paraqiti kërkesë për revision të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Komunale në Skënderaj ka refuzuar ankesën e paditësit mbi komenzimin e dëmit duke mbajtur qëndrim se nuk është kompetente të vendos për të.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykatat e shkallëve më të ulta kan shkelur LPK-në ngase në shkresat e rastit nuk shihet qartë se i padituri ishte pjesëtar i UNMIK-ut apo ka vepruar në emër të UNMIK-ut siq parashihet në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47. Prandaj Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e bazuar.

Rev.nr.118/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKAYA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylfiu, Shahdane Agani, Vjosa Nimani-Zylifu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit I.R. nga fshati Dashevcë, Komuna e Skenderajit, të cilin e përfaqëson Zenel Ademi avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës ACT-International, në Shipol Komuna e Mitrovicës, për shpërblimin e dëmit përkitazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac.nr.341/2003 datë 26.04.2005, në seancën e mbajtur me 20.07.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditësit dhe prishet aktvendimi i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë Ac.nr.341/2003 datë 26.04.2005 dhe ai i Gjykatës Komunale Skenderaj C.nr.148/2003 datë 05.08.2003, ndërsa lënda i kthehet së njëjtës gjykatë për vendosje.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Komunale Skenderaj C.nr.148/2003 datë 05.08.2003, gjykata e shkallës së parë është shpallur absolutisht jokompetente për të vepruar sipas padisë së paditësit dhe është hedhur poshtë padia e paditësit për shpërblimin e dëmit.

Gjykata e Qarkut Mitrovicë me aktvendimin Ac.nr.341/2003 datë 26.04.2005, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe aktvendimin e Gjykatës Komunale Skenderaj e ka vërtetuar.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ky dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për vendosje sipas padisë së paditësit.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 386 lidhur me nenin 400 par.4 të LPK, Gjykata Supreme gjeti se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka paraqitur padi kundër së paditurës ACT-International Shipol-Mitrovicë, për shpërblimin e dëmit material, për shkak të mosdorëzimit të materialit ndërtimor. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se sipas nenit 3 pika 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/47 e paditura është në kuadër të personelit të UNMIK-ut, prandaj gjykata nuk është kompetente në këtë çështje juridike dhe padia e paditësit është hedhur poshtë për shkak të jokompetencës absolute.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme ka vlerësuar se aktvendimet e goditura të gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 354 par.1 lidhur me par.2 pika 8 të LPK.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se konkludimi i gjykatave të instancës më të ulët është i paqëndrueshëm, sepse nga shkresat e lëndës nuk mund të konkludohet se “e paditura është organizatë në kuadër të UNMIK-ut”, sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut

nr.2000/47, siç thuhet në arsyetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, as sipas nenit 3 pika 3.1 dhe 3.3 të të njëjtës rregullore që e paditura “bën pjesë në kuadër të personelit të UNMIK-ut”, siç kanë vlerësuar gjykatat e instancës më të ulët.

Meqë, nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet fakti se e paditura është formuar nga ana e UNMIK-ut që vepron në kuadër të UNMIK-ut në pajtim me rezolutën 1244 (1999), sipas nenit 1 të Rregullores 2000/47, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në rastin konkret gabimisht janë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, paraparë nga neni 354 par.1 lidhur me nenin 16 të LPK, të cilat kanë qenë në ndikim për marrjen e një vendimi të ligjshëm lidhur me kompetencën lëndore, për të cilat arsye u desh të prishen aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët. Një arsyetim i tillë është plotësisht i pakuptueshëm dhe kundërtshëm me nenin 3 pika 3.1 dhe 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/47. Sipas nenit 3 pika 3.1 të kësaj rregulloreje është caktuar se prona e UNMIK-ut, fondet dhe pasuritë e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor, ndërsa me pikën 3.3 është caktuar personeli i UNMIK-ut gjegjësisht, cilët persona janë të liruara nga proceset ligjore. Vërtetë e paditura është organizata ndërkombëtare me element ndërkombëtar, por e njëjta veprimtarinë e zhvillon edhe në Kosovë, ashtu që gjykata e shkallës së parë është detyruar në rigjykim të vërtetojë faktin që e paditura, nëse e ka statusin e personit juridik a i nënshtrohet juridiksionit vendor si çdo person juridik tjetër vendor ose ndërkombëtar, dhe faktin se e paditura a është organizatë në kuadër të UNMIK-ut, apo organ i pavarur me element ndërkombëtar i cili zhvillon veprimtarinë edhe në Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë shkeljet thelbësore të procedurës kontestimore, duke i pasur parasysh thëniet e revizionit dhe me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale të vendosë sipas ligjit.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 394 par.1 lidhur me nenin 400 par.4 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.118/2005, më 20.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

Gjykata Supreme duke vendosur mbi Proceduren Civile - kthim në vendin e punës neni 8, 9 Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2002/10 revision i aktgjykimit kërkesa refuzohet]

Paditësi paraqiti kërkesë për revision të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Pejë ka detyruar të paditurin ta kthejë paditësin në vendin e tij të mëparshëm të punës dhe t'ia kopmenzoj atij pagat mujore për periudhen për të cilën nuk ishte lëjuar ti kryej detyrat e tij.

Gjykata Supreme ka vendosur se gjykatat e shkallës më të ulët kanë shqyrtuar kërkesat në bazë të dëshmimeve të marra dhe kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm në vendimin e vet. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e pabazuar.

Rev.nr.120/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit R.D., nga Peja, kundër të paditurës Shkolla e Mesme e Mjekësisë në Pejë, për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, përkritazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.29/2004 datë 05.04.2005 dhe aktgjykimit të Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.28/2003 datë 17.10.2003, në seancën e mbajtur më 21.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.29/2004 datë 05.04.2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.28/2003 datë 17.10.2003.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale Pejë, C.nr.28/2003 datë 17.10.2003, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit që të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës-profesor i gjuhës dhe letërsisë së gjuhës shqipe dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale për kohën sa paditësi ka qenë i penguar të punojë në vendin e tij të punës si dhe të kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e Qarkut Pejë me aktgjykimin, Ac.nr.29/2004 datë 05.04.2005, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe të shkallës së parë paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të pranohet, ose aktgjykimi i shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjyqimeve të goditura, Gjykata Supreme e Kosovës sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar tek e paditura në vendin e punës profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Sipas udhëzimit administrativ nr.10/2002 datë 20.08.2002 Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka udhëzuar punëtorët e arsimit dhe i ka njoftuar se shkollës fillore i është shtuar klasa e nëntë orientuese kalimtare e cila do të punojë në lokalet e shkollës së mesme. Me nenin 8 të këtij udhëzimi administrativ është paraparë që drejtoritë komunale të arsimit në bashkëpunim me zyrtarët e lartë të arsimit si dhe me drejtorët e shkollave të mesme janë të detyruar që të bashkëpunojnë për përzgjidhjen e kuadrit mësimor në çdo shkollë dhe se në rast të kontestimeve të ndryshme vendimin përfundimtar do ta marrë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Sipas udhëzimit të lartpërmendur paditësi

është caktuar që të punojë në Shkollën e Mesme “Ali Hadri”, në Pejë, të cilën gjë paditësi e ka refuzuar. Kundër emërimit që të mbajë mësim në klasat e nënta paditësi është ankuar, por me vendimin e Ministrisë të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë datë 10.01.2003 është refuzuar ankesa e tij si e pabazuar dhe është vërtetuar vendimi i zyrtarit të zyrës për zhvillimin e arsimit në Pejë, nr.244/2002.

Në bazë të kësaj gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe, si të tillë e ka refuzuar.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore në tërësi i ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë. Ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. E ka refuzuar ankesën si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në bazë të gjendjes të vërtetuar faktike, gjykatat e instancës më të ulët drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Kjo ngase sipas dispozitës së nenit 8 dhe 9 të udhëzimit administrativ të MASHT-it i cili ka hyrë në fuqi më 20 gusht 2002, paditësi është caktuar në vendin e punës profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Shkollën e Mesme Ekonomike “Ali Hadri” në Pejë. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 datës 24 dhjetor 1999, sipas nenit 1 (a) parashihet se ligjet e aplikueshme në Kosovë janë rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerrura në përputhje me këtë Rregullore si dhe ligjet në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989-nenit 1.1 (b) e Rregullores së përmendur. Nga kjo del se udhëzimi administrativ i lartpërmendur i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është nxjerrë në bazë të Rregullores të UNMIK-ut nr.2001/19 i datës 13 shtator 2001 dhe ky udhëzim administrativ përfaqëson instrument ndihmës i cili zbatohet nga ana e zyrtarëve të lartë të arsimit dhe të shkollave të mesme, prandaj nuk mund të thuhet se në këtë rast gabimisht është zbatuar e drejta materiale.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase gjykata e shkallës së dytë

i ka shqyrtuar thëniet ankimore përkitazi me faktet vendimtare dhe në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 393 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.120/2005, më 21.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Procedurën Civile përcaktimi i të drejtës së pronësisë - neni 37 (2) Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore revizion i aktgjykimit kërkesa refuzohet]

Paditësi paraqiti kërkesë për revision të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Komunale në Kamenicë ka refuzuar kërkesën e paditësit për përcaktimin e pronësinë mbi parcelat kadastrale.

Gjykata Supreme ka vendosur se pronari është i obliguar ta dëshmoj të drejtën e tij pronësore të cilën e pretendon, siq është paraparë në nenin 37 paragrafi 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore. Gjykata Supreme ka vendosur se gjykatat e shkallës më të ultë kanë aplikuar drejtë ligjin duke marrë parasysh faktin se paditësi nuk ka sjellë dëshmi mbi të drejtën e vet të pronësisë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e pabazuar.

Rev.nr.126/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylifu, Shahdane Agani, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit R.K. nga fshati Rogaqicë, të cilin e përfaqëson Mustafë Musa, avokat nga Gjilani, kundër të paditurve R.G. dhe T.G. që të dy nga Prishtina, S.G. nga Gjilani dhe L.K. nga Rogaqica, që të paditurin e dytë dhe të tretë e përfaqëson i padituri i parë R.G. nga Prishtina, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, përkitazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Gjilan Ac.nr.25/2004 datë 19.02.2004, në seancën e mbajtur më 20.07.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Gjilan Ac.nr.25/2004 datë 19.02.2004.

A r s y e t i m i

Me pjesën II. të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë C.nr.28/2003 datë 29.09.2003, është refuzuar si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, që të vërtetohet që ai është pronar i një pjese të ngastrës kadastrale nr.1948 me sipërfaqe dhe me kufijtë, të përshkruar si në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit dhe të vërtetohet që ajo sipërfaqe është pjesë përbërëse e ngastrës kadastrale nr.1947, pronë e paditësit në bazë të shitblerjes dhe parashkrimit fitues, ndaj të paditurit L.K.. Është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Qarkut Gjilan me aktgjykimin Ac.nr.25/2004 datë 19.02.2004, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale Kamenicë e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Gjilan, paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që aktgjykimi i shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë të prishen dhe lënda t'i kthehet për rigjykim të së njëjtës gjykatë, ose ato në pjesën II. të dispozitivit të aktgjykimit të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit të pranohet si e bazuar.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur, sipas nenit 386 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi me padi kërkon të vërtetohet se ai është pronar i një pjese të ngastrës kadastrale nr.1948, të cilin e mban i padituri L.K. (vëllai i paditësit), në atë mënyrë që kufirin në mes të dy ngastrave kadastrale nr.1947 dhe 1948 e ka prishur i padituri L. në vitin 2001 dhe pa kurfarrë baze juridike e shfrytëzon atë pjesë të ngastrës nr.1948.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të fakteve të vërtetuara, ka konstatuar se në mes të ngastrave kadastrale nr.1947 dhe 1948 ekzistojnë kufijtë dhe ngastra kadastrale nr.1948 me pjesën lindore kufizohet me ngastrën nr.1947 pronë e paditësit, ndërsa pjesa tjetër (gjysma e ngastrës), nr.1948 sipas fletës poseduese nr.32 evidentohet në emër të paditurit L.K..

Sipas konstatimit të ekspertit-gjeometrit në bazë të dokumentacionit që posedon drejtorati në Kamenicë që nga viti 1962 e gjer më tani kufiri në mes të ngastrave kadastrale nr.1948 dhe 1947 nuk është ndryshuar, ashtu që kadastri përshkrues, për rastin konkret nuk ka kurrfarë ndikimi në caktimin e vijës kufitare në mes të ngastrës 1947 dhe 1948, ngase sipas ekspertit kadastri përshkrues nuk përcakton masat e ngastrës kadastrale sipas gjatësisë dhe gjerësisë .

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar me administrimin e provave të nevojshme, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Të njëjtin qëndrim juridik lidhur me zbatimin e së drejtës materiale e ka marrë edhe gjykata e shkallës së dytë, me rastin e refuzimit të ankesës si të pabazuar.

Nisur nga gjendja e lartpërmendur, Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët i kanë zbatuar drejtë dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Në aktgjykimet e cekura ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Sipas nenit 37 par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike, pronari është i detyruar ta provojë të drejtën e pronësisë-shfrytëzimit, për të cilën kërkon kthimin e sendit, kështu që, duke marrë parasysh se paditësi nuk ka dhënë prova për vërtetim të bazës juridike të pronësisë ose të shfrytëzimit të paluajtshmërisë, si dhe faktin se ½ të ngastrës kadastrale është pronë e të paditurit dhe nuk kufizohet me ngastrën kadastrale nr.1947 pronë e paditësit, ashtu që paditësi nuk ka qenë në shfrytëzim të kësaj paluajtshmërie, të dy gjykatat e kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale.

Në revizionin e paditësit vetëm në mënyrë të përgjithësuar thuhet se aktgjykimet e gjykatave më të ulëta përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato, andaj duke pasur parasysh edhe dispozitën e nenit 386 të LPK, sipas së cilës aktgjykimi i kundërshtuar vlerësohet vetëm brenda kufijve të arsyeve të cekura në revizion, gjykata e revizionit konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Sa u përket thënieve në revizion që gjykata e shkallës së parë

nuk ka vepruar sipas dispozitës së nenit 377 të LPK, gjegjësisht nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të cekura në aktvendimin të Gjykatës së Qarkut Gjilan Ac.nr.190/2002 datë 29.11.2002, janë të pabazuara, për arsye se nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë në tërësi ka vepruar sipas nenit 377 të LPK, ashtu që në procedurë përsëri është dëgjuar eksperti lidhur me parcelën kontestuese i cili ka deklaruar që kufiri në mes të ngastrës 1948 dhe 1947 është real dhe ky konstatim është në bazë të dokumentacionit komplet të DGJKP në Kamenicë i vitit 1962, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate, thëniet e revizionit për ndërprerjen e procedurës në këtë çështje kontestimore gjer te kthimi i dokumentacionit nga Serbia është e pabazuar.

Të pabazuara janë edhe thëniet në revizion se aktgjykimi i shkallës së dytë nuk jep sqarime përkitazi me thëniet në ankesë. Përkundrazi, me aktgjykimin e shkallës së dytë janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me thëniet të cekura në ankesë të cilat janë vlerësuar si të pabazuara.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 393 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.126/2004, më 20.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Procedurën Civile - braktisje e banesës së uzurpuar - neni 20, 37 (2) Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore neni 1.2 Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 revizion i aktgjykimit kërkesa refuzohet]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e ka miratuar kërkesën e paditësit dhe ka detyruar të paditurin ta braktis banesën e paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se gjykatat e shkallëve më të ulëta e kanë aplikuar drejtë ligjin dhe e kanë përcaktuar drejtë situatën faktike. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është e pabazuar.

Rev.nr.135/2003

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rexhep Haxhimusa, kryetar, mr.sc.Rifat Zylfiu, Shahdane Agani, dr.Hamdi Podvorica dhe mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A.D., nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson Xhafer Maliqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit S.Th., nga Skenderaj, për lirim të banesës, sipas revizionit të paditurit dhe të ndërhyrësit - Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë, të cilin e përfaqëson punëtori i saj S.B., me autorizim, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac.nr.340/03 datë 22 gusht 2003, në seancën e mbajtur më 8 shtator 2005, mori

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurit dhe i ndërhyrësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac.nr.340/2003 datë 22 gusht 2003.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac.nr.340/2003 datë 28 gusht 2003, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe ndërhyrësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Skenderaj, C.nr.40/2003 datë 4 qershor 2003, me të cilin është pranuar kërkesëpadia e paditësit, është detyruar i padituri t'ia lirojë paditësit nga personat dhe sendet banesën e cila gjendet në Skenderaj, në rrugën “Adem Jashari” nr.67/7, e cila përbëhet prej dy dhomave, kuzhinës, paradhomës, korridorit, banjës, wc, ballkonit me podrum, me sipërfaqe prej 81 m², dhe t'i paguajë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 880 €, tërë këto në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë, me kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri dhe ndërhyrësi me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e cekura të gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit ose të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizionet janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave ka vërtetuar se Gj.Ç., nga Skenderaj, sipas bazës së marrëdhënies së punës ka qenë titullar i të drejtës së shfrytëzimit, dhe në bazë të aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Komonale në Skenderaj, Nd.Nr.85/99 datë 12.02.1999, e cila e zëvendëson kontratën e blerjes, e ka fituar të drejtën e pronësisë të banesës kontestuese. Pastaj, paditësi në bazë të kontratës së këmbimit të lidhur me ish pronarin Gj.Ç., të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Mitrovicë, Leg.Nr.710/2002 datë 28 maj 2002, e ka fituar të drejtën e pronësisë të banesës së përmendur.

I padituri është vendosur në banesën kontestuese, ka refuzuar që t'ia lirojë paditësit banesën, me arsyetim se pronar i kësaj banese

është PTK e Kosovës, e cila ia ka dhënë ta shfrytëzojë me qira, ashtu paditësit ia ka kontestuar të drejtën e pronësisë së banesës dhe ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia.

Procedurës kontestimore iu ka bashkuar edhe ndërhyrësi PTK, i cili paditësit ia ka kontestuar të drejtën e pronësisë në banesën kontestuese me arsyetim se ajo banesë është pronë e ndërhyrësit, se të paditurit, sipas bazës së marrëdhënies së punës, iu ka dhënë ta shfrytëzojë me qira dhe ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë në mbështetje të gjendjes së tillë të vërtetuar faktike ka gjetur se paditësi është pronar i banesës kontestuese, se ka të drejtë të kërkojë kthimin e saj në posedim dhe me zbatimin e nenit 20 dhe 37 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko-pronësore (LMTHJP), ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, në bazë të gjendjes së tillë, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e të paditurit dhe të ndërhyrësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e të paditurit dhe të ndërhyrësit, të cekura në revizion se, siç theksohet, aktgjykimet e cekura të gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore paraparë nga neni 354 par. 2 pika 7 dhe 13, lidhur me nenin 16 dhe 357 të LPK, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate për gjykimin e kësaj çështje juridike kompetente lëndore është gjykata e jo Drejtoria për çështje pronësore banesore, siç drejtë kanë gjetur edhe gjykatat e instancës më të ulët, sepse sipas nenit 1 par.2 nën b. të Rregullores së

UNMIK-ut nr.1999/23, është paraparë që si përjashtim nga juridikcioni i gjykatave lokale Drejtoria për çështje pronësore banesore është kompetente lëndore të vendosë për kërkesat e personave fizikë që kanë të bëjnë me pronësinë e banesave në bazë të transaksioneve jozyrtare të lidhura në periudhën prej 23 mars 1989 deri më 13 tetor 1999, të cilat transaksione, siç është paraparë me nenin 2 par.2.3 të Rreg. së UNMIK-ut nr.60/2000, kanë qenë të paligjshme, ndërsa paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë së banesës në bazë të kontratës së këmbimit të lidhur më 27 maj 2002 të vërtetuar në gjykatë më 28 maj 2002 do të thotë pas periudhës kohore të paraparë me dispozitat e sipërpërmendura juridike.

Thëniet se ngastra nr.108 me kulturë ndërtesë, në përbërje të cilës gjendet edhe banesa kontestuese, dhe oborr në sipërfaqe prej 2.90 ari, sipas fletës poseduese nr.24 për KK. Skenderaj është në pronën shoqërore, prandaj sipas vlerësimit të paditurit dhe ndërhyrësit gabimisht është aplikuar e drejta materiale nga neni 20 dhe 37 të LMTHJP, janë të pabazuara, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate banesa kontestuese, siç del nga gjendja në shkresat e lëndës, ka qenë e destinuar për banim, e jo për ushtrimin e veprimtarisë zyrtare siç ceket në revizion, sepse më parë të drejtën e banimit e ka pasur punëtori R.J., i cili e ka humbur atë të drejtë dhe se, siç u tha më parë atë të drejtë më vonë e ka fituar ish pronari Ç.Gj. në bazë të aktvendimit të formës së prerë, i cili vendim përfaqëson bazë juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë së banesës së përmendur, me të cilën ky pronar ka qenë i autorizuar që me atë banesë të disponojë, ndërsa fakti se gjendet në ngastrën e cila evidencohet si pronë shoqërore nuk do të thotë se banesa kontestuese si pjesë etazhe e ndërtesës nuk mund të jetë në pronësi private, e cila në të vërtetë është transformuar në pronësi private sipas bazës valide juridike, prandaj edhe çdo vendim i marrë nga ana e PTK të Kosovës, pas datës kur aktvendimi i gjykatës kompetente, në bazë të cilës është bërë transformimi i pronës shoqërore në atë private, ka marrë formën e prerë, do të jetë i paligjshëm. Kontrata për këmbimin e banesave e lidhur mes paditësit dhe ish pronarit Ç.Gj., nga Skenderaj është valide dhe sipas nenit 20 të LMTHJP përfaqëson bazë juridike të vlefshme për fitimin e të drejtës së pronësisë së banesës, se sipas nenit 37 par.1 të këtij ligji është paraparë se pronari mundet me padi të kërkojë nga poseduesi kthimin e sendit individualisht të caktuar, prandaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancës më të ulët drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Thëniet tjera të theksuara në revizion sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit nuk janë me ndikim në ligjshmërinë e aktgjyqimit të goditur.

Nga sa u tha më sipër Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat janë paraqitur revizionet dhe me zbatimin e nenit 393 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.135/2003, më 08.09.2005

Kryetari i kolegjit,
Rexhep Haxhimusa

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Procëduren Civile - përcaktimi i pronësisë - neni 29 Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore - neni 354 (2) ((14)) LPK - neni 365 (2) LPK - revizion i aktgjykimit kërkesa pranohet]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut në Prizren pranoi ankesën e paditësit dhe vërtetoi se asaj I është dhënë parcela kadastrale.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur se vendimet e gjykatave të shkallës më të ultë kanë përmabjtë shkelje të LPK-së bazuar në përcaktimin e gabueshëm të gjendjes faktike, siq parashihet në nenin 354 paragraf.2 pika 14 LPK dhe nenin 354 paragraf 1 së bashku me nenin 365 paragraf 2 LPK.

Gjykata Supreme ka vendosur se shkeljet esenciale të procedurës kontestimore bazohen në faktin se ka mospërputhje në mes të deklaramit në arsyetim dhe provave të paraqitura në senancën kryesore. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është e bazuar.

Rev.nr.137/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, mr.sc.Rifat Zylfiu, Shahdane Agani, Meleqe Behxheti dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses A.Ç. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson Ruzhdi Berisha avokat në Prizren, kundër të paditurve N.U. dhe M.U. nga Prizreni, të cilët i përfaqëson Ibish Çakalli, avokat nga Prizreni dhe të paditurit KBI "Progres" NSH "Lavërtaria Blegtoria" në Prizren lidhur me vërtetimin e pronësisë dhe shpalljen e aktvendimit për pëmbarrim si të palejueshëm, përkitazi me revizionin e të paditurve N.U. dhe M.U., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.254/2003 datë 28 janar 2004, në seancën e mbajtur më 21 korrik 2005, mori këtë

A K T V E N D I M

MIRATOHET revizioni i të paditurve N.U. dhe M.U. dhe

PRISHEN aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.254/2003 datë 28 janar 2004 dhe ai i Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.556/2002 datë 17.12.2002 kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktgjykimin Ac.nr.254/2003 datë 28 janar 2004, e ka refuzuar ankesën e të autorizuarit të paditurve N. dhe M.U., avokatit Ibish Çakalli nga Prizreni dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.556/2002 datë 17.12.2002, me pjesën e parë të dispozitivit të të cilit është miratuar kërkesëpadia e paditëses A.Ç. dhe është vërtetuar se ajo, në bazë të parashkrimit fitues është pronare e ngastrës kasdastrale nr.6674, të evidentuar në fletën poseduese nr.8417 kk Prizren, në sipërfaqe prej 20.55 ha. dhe i ka detyruar të paditurit që këtë fakt ta pranojë dhe të lejojë regjistrimin e ngastrës në emër të paditëses; me pjesën e dytë të dispozitivit është shpallur i palejueshëm pëmbarrimi i caktuar me aktvendimin e po asaj gjykate E.nr.22/2001 datë 22.06.2001.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.254/2003 datë 28 janar 2004, të paditurit N. dhe M.U., nëpërmjet të autorizuarit, Ibish Çakall, avokat nga Prizreni, kanë ushtruar revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Kanë propozuar që Gjykata Supreme aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshojë ashtu që ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, ose aktgjykimin e goditur ta prishë dhe lëndën ta kthejë për rigjykim.

Gjykata Supreme, pasi që, në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) e shqyrtoi aktgjykimin e goditur, gjeti se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se bashkëshorti i së paditurës N.U. respektivisht baba i të paditurit M.U., ka qenë pronar i ngastrës kontestuese. Ai me kontratatë për shitblerje Leg.Nr.274/63 datë 21.02.1963 dhe me kontratën Leg.nr.1692/68 datë 06.12.1968 ia ka shitur këtë paluajtshmëri të

paditurit të tretë KBI "Progresi" Prizren. Në bazë të kontratës për ndërrimin e paluajtshmërive Leg.Nr.349/67, datë 15.04.1967 të lidhur ndërmjet të paditurit të tretë dhe Xh.Q., nga Prizreni, pronar i paluajtshmërisë kontestuese është bërë Xh.Q., i cili me kontratën e lidhur më datë 11.12.1970, Leg.1441/70 këtë paluajtshmëri ia ka shitur A.Q., këtu paditëses, e cila prej asaj kohe e ka në posedim dhe shfrytëzim të lirë. Kjo paluajtshmëri në librat kadastrale evidentohet si pronë e të paditurit të tretë.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, thuhet se Gjykata Komunale në Prizren me aktgjykimin C.nr.69/2000, datë 01.01.2001 i ka anuluar kontratat për shitblerjen e ngastrës kontestuese të lidhura ndërmjet bashkëshortit, respektivisht babit të të paditurve dhe të paditurit të tretë me arsyetim se këto kontrata janë lidhur në rrethanat e presionit. Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.28/74, datë 23.06.74 është anuluar kontrata për ndërrimin Leg.Nr.349/67, datë 15.04.1967 e paluajtshmërive të lidhur ndërmjet të paditurit të tretë dhe Xh.Q.. Me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr.22/01 datë 22.06.2001 është caktuar përmbarimi me qëllim që të paditurve t'iu dorëzohet në pronësi dhe posedim paluajtshmëria kontestuese. Në bazë të kundërshtimit të paditëses, si person i tretë, të ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbarimit, është ndërprerë procedura e përmbarimit. Paditësja ka iniciuar kontestin civil.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësja është poseduese me mirëbesim e ngastrës kontestuese që nga viti 1970, nga arsyeja se në posedim ka hyrë në bazë të punës së vlefshme juridike - kontratës së shitblerjes të lidhur me Xh.Q., i cili ka qenë pronar i ngastrës në momentin e lidhjes së kontratës, se ngastrën kontestuese e ka shfrytëzuar pa u penguar nga askush në asnjë mënyrë dhe se, për faktin se kontrata për shitblerje Leg.nr.274/63 datë 21.02.1963 dhe ajo për dhurimin Leg.nr.1692/68 datë 06.12.1968, në bazë të të cilave ngastra kontestuese është evidentuar në librat kadastrale si pasuri shoqërore, me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.69/2000 janë shpallur nule, ato asnjëherë nuk kanë qenë pasuri shoqërore, prandaj e ka miratuar kërkesëpadinë e saj dhe e ka shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vendosur sipas ankesës, aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar dhe ka konstatuar se me atë aktgjykim nuk janë bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore, se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe se e drejta materiale është zbatuar po ashtu drejtë ngase, me Ligjin për Ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike - Pronësores (Flet.zyr. e Jug.29/96) është shlyer neni 29 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike- Pronësores (LTHMJ), i cili parashikonte se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pasuri shoqërore me parashkrim fitues, pas këtij ndryshimi mbi pronën shoqërore mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues.

Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani, nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një përfundim të tillë të gjykatave të instancës më të ulët, ngase, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, këto aktgjykime janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 354 par.2 pika 14 të LPK dhe nenin 354 par.1 lidhur me nenin 365 par.2 të LPK dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ka mbetur pa u vërtetuar plotësisht gjendja faktike dhe për këtë shkak nuk ka kushte për ndryshim të aktgjykimit të goditur, prandaj të dy aktgjykimet u desh të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në faktin se ekziston kundërthënie ndërmjet asaj që thuhet në arsyetim dhe provave të administruara në seancën për shqyrtimin kryesor. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat: dëgjimin e dëshmitarit Sh.Q., bashkëshort i paditëses, dëgjimin e palëve, leximin e kontratës Leg.nr.1441/70 datë 11.12.1970 dhe ka bërë shikimin e shkresave E.nr.22/21 pa kurrfarë konstataimi se çka pëmbajnë këto shkresa. Në arsyetimin e aktgjykimit të vetë thihet në kontratat Leg.Nr.349/67, datë 15.04.1967, Leg.Nr.274/63 datë 21.02.1963 dhe Leg.nr.1692/68 datë 06.12.1968, si dhe në shkresat e lëndës së Gjykatës komunale në Prizren C.nr.28/74 dhe C.nr.69/2000, të cilat fare nuk i ka administruar si prova.

Gjykata Supreme nuk mund ta pranojë përfundimin e gjykatës së shkallës së dytë se meqë, me Ligjin për Ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësores (Flet.zyr. e Jug. 29/96) është shlyer neni 29 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësores (LTHMJ), i cili parashikonte se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pasuri shoqërore me parashkrim fitues, pas këtij ndryshimi mbi pronën shoqërore mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, norma ligjore

bëhet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, përveç nëse në ligj shprehimisht është cekuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues. Me ligjin e përmendur më lart nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanojë shkeljet e shpjeguara më lart dhe për të zbatuar drejtë të drejtën materiale duhet të nxjerrë prova me leximin dhe krahasimin me origjinalet: kontratën për shitblerje Leg.1441/70 të lidhur me Xh.Q. dhe paditëses, Leg.Nr.274/63 datë 21.02.1963 dhe kontratën Leg.nr.1692/68 datë 06.12.1968 të lidhura ndërmjet parardhsit të të paditurve dhe të paditurit të tretë, kontratën Leg.Nr.349/67, datë 15.04.1967 të lidhur ndërmjet të paditurit të tretë dhe Xh.Q. si dhe të administrojë provën me leximin e aktgjykimeve të Gjykatës Komunale C.nr.28/74 dhe, datë 23.06.1974 dhe C.nr.69/2000, datë 01.01.2001, si dhe të administrojë prova të tjera eventuale, me të cilat do t'i vërtetojë të gjitha faktet relevante dhe, pas vlerësimit të drejtë të provave, të marrë një vendim të ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë se a ka qenë me ndikim në ligjshmërinë e aktgjykimit të saj fakti se nuk është vepruar sipas dispozitës së parashikuar me nenin 29 të Rregullores 12/2002 "Për themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës"

Nga sa u tha më lart, e në përputhje me dispozitën e nenit 394 par.1 dhe 395 par.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPRME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.137/2005, më 21.07.2005

Kryetarja e kolegjit,
Vjosa Nimani-Zylfiu

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Proceduren Civile - pasurim i pabazë nenet 49, 73 Ligji Themelor i Punës - 354 (2) ((14)) LPK - neni 365 (2) LPK revizion i aktgjykimit kërkesa pranohet]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi të paditurin, t'ia paguaj paditësit 3.500 € në emër të pagave të papaguara dhe meditjeve.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur se vendimet e gjykatave të shkallës më të ultë kanë përmabjtë shkelje të LPK-së bazuar në përcaktimin e gabueshëm të gjendjes faktike, siq parashihet në nenin 354 paragraf.2 pika 14 LPK dhe nenin 354 paragraf 1 së bashku me nenin 365 paragraf 2 LPK.

Gjykata Supreme ka vendosur se shkeljet esenciale të procedurës kontestimore bazohen në faktin se ka mospërputhje në mes të deklaramit në arsyetim dhe provave të paraqitura në senancen kryesore. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e të paditurit është e bazuar.

Rev.nr.153/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit I.K., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Gani Tigani, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, në Prishtinë, për pasurimin pa bazë, përkritazi me revizionin e paditësit dhe të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.79/2003 datë 22.04.2004, në seancën e mbajtur më 20.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Pranohet revizioni i të paditurës dhe prishen aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.79/2003 datë 22.04.2004 dhe

aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prishtinë, C.nr.227/2002 datë 26.11.2002, në pjesën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prishtinë, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.79/2003 datë 22.04.2004, që ka të bëjë me pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prishtinë, C.nr.227/2002 datë 26.11.2002.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prishtinë, C.nr.227/2002 datë 26.11.2002, pjesërisht është pranuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguajë shumën prej 3.500 € në emër të kompensimit të pagave të papaguara dhe të shujtës ditore për periudhën 01.09.1999 deri më 30.06.2000. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit që ka të bëjë për pagat dhe shujtën ditore për periudhën pas datës 30.06.2000. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 363 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë paraqitur revizion:

-paditësi, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet dhe të pranohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit ose të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim;

-e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet ose të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit

të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se revizioni i paditësit është i pabazuar, ndërsa revizioni i të paditurës është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë, me administrimin e provave ka gjetur se: “paditësi pas përfundimit të luftës nuk ka rithemeluar marrëdhënie të punës te e paditura, por ai është paraqitur në punë si ish punëtor i të paditurës me qëllim të vazhdimit të marrëdhënies së punës. Por, meqë kryerja e punëve të vendit të caktuar të punës paraqet çështje faktike, e cila në rastin konkret është vërtetuar se është bërë me pëlqimin e të paditurës, pa marrë parasysh se lidhur me punën me paditësin nuk ka qenë lidhur ndonjë kontratë apo ndonjë marrëveshje me shkrim, pasi që ato punë janë kryer në interes të paditurës e të cilat kanë çmimin e vet që, në rastin konkret, nënkupton lartësinë e pagës mujore për vendin gjegjës të punës”, prandaj ka vendosur si në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit. Ndërsa, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë paraqitja e paditësit në punë në periudhën prej 01.07.2000 deri më 19.04.2001, është bërë me vetiniciativë pa iu dhënë atij ndonjë punë konkrete nga e paditura dhe se prezenca fizike e paditësit në lokalet e punës së të paditurit vetvetiu, pa ekzistimin e ndonjë raporti juridik në mes paditësit dhe të paditurës nuk përfaqëson kurfarë baze që do t'i jepte paditësit të drejtë që të kërkojë ndonjë shpërblim nga e paditura, prandaj ka vendosur si në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, në tërësi i ka pranuar konstatimet dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë. Ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund ta pranohë konkludimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën I të dispozitivit është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 354 par.2 pika 14 të LPK, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike dhe për këtë shkak nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, prandaj për këto arsye është dashur që të dy aktgjykimet e lartpërmendura që ka të bëjë me pjesën I të dispozitivit të

aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban të dhëna përkitazi me faktin nëse paditësi i larguar nga ndërmarrja e paditur me caktimin e masave të dhunshme iu ka ndërprerë marrëdhëniet e punës apo gjatë kohës deri sa ka qenë jashtë marrëdhënies së punës të drejtat nga marrëdhëniet e punës u ka pushuar dhe me kthimin e tij në punë ka vazhduar t'i ushtrojë apo do të thotë se tani, me kthimin e tij në punë, ka themeluar marrëdhënie të re të punës dhe se të drejtat nga marrëdhëniet e punës ka filluar t'i ushtrojë nga momenti i fitimit të cilësisë së punëtorit në ndërmarrjen e paditur. Nëse konsiderohet se nuk iu ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, kthimi i paditësit në punë është çështje teknike, ndërsa nëse për kthimin e tij në punë është dashur të vendos organ i kompetent me vendimin e tij, atëherë do të thotë se nuk është fjala për çështje teknike, por vendimi i organit kompetent ka efekt juridik për krijimin e marrëdhënies së punës dhe fitimin e të drejtave të punëtorit nga marrëdhëniet e punës nga momenti kur paditësi, sipas atij vendimi fillon të punojë. Nga kjo del se mes palëve ndërgjyqëse është kontestues fakti se paditësi në periudhën kontestuese a ka dalë në punë me vetiniciativë, si dhe fakti se a iu ka bërë paditësit i pamundur kthimi në punë me vendimin e paligjshëm të ndërmarrjes së paditur, nga i cili fakt varet përgjegjësia e të paditurës për pagesën e shpërblimit të dëmit për fitimin e humbur, të cilin paditësi do ta kishte realizuar nga marrëdhëniet e punës sipas rrjedhjes normale të ngjarjes, sikur të kishte punuar në vendin e punës për periudhën e cekur në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Përkitazi me këto fakte nuk është administruar asnjë provë.

Sipas dispozitës së nenit 73 të Ligjit të Marrëdhënieve Themelore nga Marrëdhëniet e Punës është paraparë se nëse punëtori pëson dëm në punë ose lidhur me punën, punëdhënësi është i detyruar që t'ia shpërblejë atij dëmin sipas parimeve të përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin. Dëmi mund të shkaktohet si pasojë e veprimit të paligjshëm ose lëshimit-deliktit civil. Kur gjykata me administrimin e provave të nevojshme vërteton se punëtorit me vendimin e paligjshëm të punëdhënësit iu ka cënuar e drejta nga marrëdhëniet e punës, në rastin konkret iu ka bërë e pamundur të punojë në vendin e punës, për të cilin shkak nuk ka realizuar të ardhurat personale, të cilat do t'i kishte realizuar sikur të kishte punuar, punëtorit i takon e drejta e shpërblimit të dëmit.

Sipas nenit 49 të ligjit të përmendur, punëtori i takojnë të ardhurat personale në pajtim me aktin e përgjithshëm, në përpjesëtim me kontributin e tij në krijimin e të ardhurave. Përkitazi me kontributin e punëtorit në punë vendos organi punëdrejtues-drejtori ose punëtori me autorizime të veçanta, përkatësisht punëdhënësi në pajtim me aktin e përgjithshëm dhe kontratën kolektive.

Në procedurën e shkallës së parë nuk janë sqaruar të gjitha këto fakte vendimtare në pajtim me dispozitat e cekura të ligjit të lartpërmendur, nga të cilat fakte varet bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit, prandaj sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gabimisht është zbatuar e drejta materiale kur e paditura është detyruar që paditësit t'ia paguajë shumën e gjykuar në emër të të ardhurave personale si dhe në emër të shujtës, siç është vendosur në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, për të cilin shkak është dashur të prishen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta. Kjo ngase, gjykata e shkallës së parë, bazën e këtyre pagesave e ka cilësuar si pasurim pabazë, pa dhënë kurrfarë arsyesimi se ku qëndron humbja në pasurinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave të nevojshme ka gjetur se paraqitja e paditësit në punë në periudhën prej 01.07.2000 deri më 19.04.2001 është bërë me vetiniciativë të paditësit pa ekzistimin e ndonjë raporti juridik në mes të paditësit dhe të paditurës nuk përfaqëson kurrfarë baze do të jepte paditësit të drejtë që të kërkojë ndonjë shpërblim nga e paditura për këtë formë të prezencës së tij, prandaj kërkesëpadia e paditësit në pjesën II të dispozitivit është refuzuar si i pabazuar.

Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë është e pabazuar. Ka gjetur se nuk ekzistojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat ajo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejtë

dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë është e pabazuar. Në aktgjykimet e cekura ata kanë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë është e detyruar t'i mënjanojë të metat e cekura më lart dhe me administrimin e provave të nevojshme t'i vërtetojë të gjitha faktet vendimtare dhe pas vlerësimit të drejtë të provave të administruara të marrë vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 393 dhe 394 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.153/2004, më 20.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Aganit

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Proceduren Civile - kompensim i dëmit neni 354 (2) ((14)) LPK - neni 365 (2) LPK - neni 200 LMD - revizion i aktgjykimit kërkesa pranohet]

I padituri paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Komunale në Pejë e detyroi të paditurin ti paguaj paditësit për dëmet materiale për dëmtimin e mobileve dhe objekteve të tjera.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur se shuma e caktuar nga Gjykatat e shkallës më të ultë, nuk është adekuate me natyrën e kompensimit imaterial të dëmit, për vuajtjet e shkaktuara.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesat e të paditurit dhe paditësit janë pjesërisht të bazuara.

Rev.nr.186/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve Sh.B., S.B., F.B. dhe Gj.B., të gjithë nga fshati Molliq, komuna e Gjakovës, të cilët i përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Koorporata Elektroenergjetike e Kosovës-Distribucioni në Gjakovë, për shpërblimin e dëmit, përkitazi me revizionin e paditësve dhe të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.50/2003 datë 01.06.2004, në seancën e mbajtur më 20.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Pjesërisht pranohet revizioni i paditësit të dytë dhe të tretë dhe ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.50/2003 datë 01.06.2004 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale Gjakovë, C.nr.187/2000 datë 01.11.2002, në pjesën III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ashtu që e paditura

Korporata Elektroenergjetike e Kosovës-Distribucioni në Gjakovë, detyrohet që paditësve S.B. dhe F.B., të dy nga Molliqi në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e birit të tyre, t'iu paguajë shumën nga 5.000 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa mbi këtë shumë kërkesëpadia refuzohet si e pabazuar.

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.50/2003 datë 01.06.2004 dhe aktgjykimit të Gjykatës Komunale Gjakovë, C.nr.187/2000 datë 01.11.2002 në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësës Gj.B. paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.50/2003 datë 01.06.2004 dhe aktgjykimit të Gjykatës Komunale Gjakovë, C.nr.187/2000 datë 01.11.2002, në pjesën VI të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.50/2003 datë 01.06.2004 dhe aktgjykimit të Gjykatës Komunale Gjakovë, C.nr.187/2000 datë 01.11.2002, në pjesën I, III, V dhe VII të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Pranohet revizioni i paditësve dhe të paditurës, prishet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.50/2003 datë 01.06.2004 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale Gjakovë, C.nr.187/2000 datë 01.11.2002, që ka të bëjë me kamatën ligjore në pjesën I, III dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë, Ac.nr.50/2003 datë 01.06.2004, është refuzuar ankesa e paditësve dhe i paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Gjakovë, C.nr.187/2000 datë 01.11.2002, me të cilën në pjesën I të aktgjykimit pjesërisht është pranuar kërkesëpadia e paditësve, është detyruar e paditura t'iu paguajë

paditësve në emër të shpërblimit të dëmit material për shkak të dëmtimit të mobileve dhe plaçkave të tjera, shumën prej 18.293 €, me kamatën përkatëse ligjore duke filluar prej datës 28.06.2001 deri në pagesën definitive. Në pjesën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material për dëmtimin e mobileve dhe të plaçkave tjera t'iu paguajë shumën prej 12.195 €. Me pjesën III të dispozitivit pjesërisht është pranuar kërkesëpadia e paditësve S. dhe F.B., dhe është detyruar e paditura që në emër të shpërblimit të dëmit jo material-për shkak të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e birit të tyre, t'iu paguajë shumën prej nga 3.500 €, me kamatën përkatëse ligjore duke filluar prej 01.11.2002 deri në pagesën definitive. Me pjesën IV të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve S. dhe F.B., që të detyrohet e paditura, që në emër të shpërblimit të dëmit jo material-në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së fëmijës së tyre të mitur t'iu paguajë shumën prej nga 6.500 €. Me pjesën V të dispozitivit pjesërisht është pranuar kërkesëpadia e paditësës Gj.B., është detyruar e paditura në emër të dëmit jo material t'ia paguajë shumën prej 1.342 €, me kamatën përkatëse ligjore duke filluar prej 01.12.2002 deri në pagesën definitive dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 420 €, në emër të shëmtimit estetik shumën prej 480 € dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 440 €. Me pjesën VI të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësës Gj.B., që të detyrohet e paditura që në emër të dëmshpërblimit jo material t'ia paguajë shumën prej 8.160 € me kamat përkatëse dhe në pjesën VII të dispozitivit e paditura është e detyruar që paditësve në emër të shpenzimeve procedurale t'iu paguajë shumën prej 845.81 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh prej ditës kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë kanë paraqitur me kohë revizion:

-paditësit për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë në pjesën refuzuese të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësve të pranohet në tërësi ose në pjesën refuzuese të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim,

-e paditura për shkak të shkeljes thelbësore të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me

propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë në pjesën aprovuese të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pabazuar.

Paditësit kanë paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se revizioni i paditësve dhe i të paditurës pjesërisht është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave të nevojshme ka gjetur se me aktgjykimin e pjesërishtëm dhe të plotfuqishëm të njëjtës gjykatë, C.nr.187/2000 datë 21.09.2000, është vërtetuar se më 19.05.1992, në fshatin Molliq, komuna e Gjakovës, ka shpërthyer zjarri, si pasojë e mbitensionit në rrjetin distributive të paditurës, ashtu që në atë zjarr është djegur në tërësi shtëpia e paditësit Sh.B. dhe si pasojë e zjarrit dhe i gazrave, ka vdekur fëmija i mitur i paditësve S. dhe F.B., është lënduar paditësja Gj.B. si dhe janë djegur të gjitha mobilet, pajisjet shtëpiake dhe plaçkat e tjera. Prandaj, gjykata e shkallës së parë në bazë të konstatimit dhe mendimit të ekspertëve përkatës të arkitekturës dhe të elektroteknikës, ka gjetur se dëmi lëndor është shkaktuar nga rryma elektrike, respektivisht veprimtaria e rrezikshme e të paditurës dhe, sipas nenit 154 par.1, 158 dhe 173 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve ka vendosur si në aktgjykimin e lartpërmendur.

Duke u nisur nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi S. dhe F.B. kanë pësuar dëm jo material në formë të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e fëmijës së tyre. Në bazë të konstatimit dhe mendimit të ekspertit të mjekësisë, ka përfunduar se shpërblimi, për këtë formë të dëmit jo material të paditësve të lartpërmendur në shumë nga 3.500 €, është adekuat dhe përfaqëson sadsifakcion moral, me të cilin ua zbut dhimbjet e pësuar shpirtërore. Në bazë të konstatimit dhe mendimit të ekspertit mjekësor, lidhur me shkallën e intensitetit, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, shëmtimin estetik, humbjen e aftësisë së përgjithshme jetësore, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësja Gj.B. ka pësuar dëm jo material për çdo formë të përshkruar më parë të dhimbjeve, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Për kërkesëpadinë e paditësve që ka të bëjë lidhur me dëmshpërblimin material që ata kanë pasur me djegien e mobileve, pajisjeve shtëpiake dhe plaçkave të tjera, gjykata e shkallës së parë në bazë të mendimit të ekspertit të mobilierisë, duke pasur parasysh edhe deklaratat e paditësve të dëgjuar në cilësinë e palës, se mobilet dhe plaçkat janë blerë dy-tri vite para djegies së shtëpisë, sipas nenit 223 të LPK, sipas bindjes së lirë, duke e zvogëluar vlerën në masë prej 40% i pranon paditësve në emër të dëmit material shumë prej 18.293 €, ndërsa për pjesën tjetër e ka refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve pjesërisht është e bazuar. Ka gjetur se nuk ekzistojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat ajo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar në pjesën aprovuese të kërkesëpadinë më afër të përshkruar në pjesën I, III dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me dëmin material dhe jo material.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, shumica e gjykuar e gjykatës së shkallës së parë në pjesën III të dispozitivit, nuk është adekuate, nuk është në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të vdekjes së miturit, birit të paditësve S. dhe F.B., duke pasur parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky shpërblim siç është paraparë me nenin 200 par.1 dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), prandaj, kjo Gjykatë duke pranuar pjesërisht revizionin e paditësve të lartpërmendur e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën III të dispozitivit, ashtu që në emër të dëmit jo material, në formë të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e birit të tyre, paditësve të lartpërmendur u caktoi shumë prej nga 5.000 €.

Nisur nga kjo dhe duke pasur parasysh rëndësinë e së mirës së cënuar dhe duke pasur parasysh moshën e fëmijës së tyre të mitur si dhe qëllimin e përmendur të shpërblimit në të holla, kjo Gjykatë konsideron se, me ndihmën e shumave të caktuara, edhe paditësit-prindërit të fëmijës së mitur, do të mund të përjetonin një sadsifakcion të konsiderueshëm për dhimbjet shpirtërore të shkaktuara për vdekjen e fëmijës së tyre, duke qenë se i ndjeri L.B., ishte fëmija i vetëm i paditësve të lartpërmendur, ndaj tij, prindërit kanë ushqyer ndjenja të fuqishme dashurie, kanë qenë të dhënë pas tij. Këto ndjenja të tyre, si pasojë e vdekjes së fëmijës tre vjeçar, kanë rezultuar me dhimbje të thella shpirtërore. Kjo dhimbje është e pamatshme dhe nuk mund të hiqet me kurrfarë shpërblimi në të holla. Megjithatë, shpërblimi i drejtë në të holla mund të zbusë dhimbjen shpirtërore dhe, duke i kënaqur disa nevoja të caktuara jetësore, të ndikojë në vendosjen e barazpeshës shpirtërore dhe emocionale të paditësve.

Nisur nga kjo, dhe duke pasur parasysh rëndësinë e së mirës së cënuar si dhe qëllimin e përmendur të shpërblimit në të holla, kjo Gjykatë konsideron se, me ndihmën e shumave të caktuara, edhe paditësit-S. dhe F.B., do të mund të përjetonin një sadsifakcion të konsiderueshëm për dhimbjen shpirtërore të shkaktuar nga vdekja e fëmijës së tyre. Shpërblimi në të holla i dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet me të cilin të dëmtuarit, duke i kënaqur nevojat që nuk do të mund t'i plotësonin, iu bënë më të lehtë jetën e tyre dhe, duke bërë atë më të durueshme, zbut dhimbjet shpirtërore që e përjetojnë. Dëmi jo material dhe shpërblimi i këtij dëmi përjetohej, por ashtu që dëmi përbën një përjetim të pakëndshëm dhe shpërblimi i tij një përjetim të këndshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e marrjes së vendimit lidhur me kërkesën për shpërblimin e këtij dëmi jo material si dhe për shumën e shpërblimit, pati parasysh rëndësinë e së mirës së cënuar dhe qëllimin të cilit i shërben ky shpërblim si dhe faktin që ky të mos favorizojë synimet që nuk përkojnë me natyrën dhe me qëllimet e tyre shoqërore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, shuma e gjykuar të shkallës së parë në pjesën V të dispozitivit është adekuate, ngase, është në përputhje me natyrën e shpërblimit jo material siç është paraparë me nenin 200 par.1 dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD).

Nisur nga kjo dhe duke pasur parasysh rëndësinë e së mirës së cënuar dhe duke pasur parasysh moshën e paditëses Gj.B. si dhe qëllimin e përmendur të shpërblimit në të holla, kjo Gjykatë konsideron se, me ndihmën e shumës së caktuar, edhe paditësja e katërt do të mund të përjeton një sadsifakcion të konsiderueshëm për dhimbjet fizike, për dhimbjet shpirtërore, për shëmtimin estetik dhe për frikën e përjetuar, për shkak të lëndimeve të pësuar me rastin e djegies së shtëpisë së paditëses. Shpërblimi në të holla i dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet me të cilin e dëmtuara, duke i kënaqur nevojat që nuk do të mund t'i plotësonin, ia bënë më të lehtë jetën vetës dhe, duke e bërë atë më të durueshme, zbut dhimbjen shpirtërore që përjeton.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale ku kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë-në pjesën I, III, V të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa ka gjetur se është e pabazuar kërkesëpadia e paditësve në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë-në pjesën II, IV dhe VI të dispozitivit të gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i goditur në pjesën I, III dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe të paditurës dhe në këto pjesë të dispozitivit e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Prandaj, nuk qëndrojnë thëniet në revizionin e të paditurës se gjykata e shkallës së dytë nuk i ka shqyrtuar thëniet ankimore përkitazi me faktet vendimtare, kjo ngase, gjykata e shkallës së dytë i ka shqyrtuar thëniet ankimore përkitazi me faktet vendimtare dhe në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon kjo Gjykatë, edhe pse në revizion nuk ceket konkretisht se cilat thënie ankimore gjykata e shkallës së dytë nuk i ka shqyrtuar.

Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund të pranojë konkludimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me pjesën I, III, V të dispozitivit, që ka të bëjë me kamatën ligjore, ngase në këtë

pjesë aktgjykimi i goditur përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 354 par.2 pika 14 të LPK.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se aktgjykimi në pjesën I, III dhe V të dispozitivit, që ka të bëjë me detyrimin e së paditurës që paditësve t'iu paguajnë kamatën përkatëse ligjore, është i pakuptueshëm dhe i papërmbarueshëm sepse nuk është përcaktuar përqindja e kamatës, për të cilën arsyetimi i aktgjykimit nuk përmban asnjë fjalë. Në këtë mënyrë është bërë shkelje thelbësore e dispozitës së procedurës kontestimore nga neni 354 par.2 pika 14 të LPK, që është shkak për prishjen e aktgjykimit.

Ngase sipas nenit 385 par.3 të LPK, nuk mund të paraqitet revizion për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, thëniet e revizionit që kanë të bëjnë me gjendjen faktike, Gjykata Supreme nuk i vlerësoi.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të urdhërojë paditësve që të bëjnë preçizimin e lartësisë së kamatës, duke përcaktuar përqindjen e saj dhe të vendosë sipas lartësisë së kamatës që paguajnë bankat dhe, pastaj të vendosë për bazueshmërinë e kësaj kërkesëpadie, duke e pasur parasysh se kamata mbi shumën e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material caktohet nga dita e martjes së aktgjykimit të shkallës së parë.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 394 par.1 lidhur me nenin 395 par.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.186/2004, më 20.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Proceduren Civile - blerje e patundshmërisë anulim i kontratës neni 354 (2) ((14)) LPK - neni 365 (2) LPK nenet 103, 104 LMD - revizion i aktgjykimit kërkesa refuzohet]

Paditësi paraqiti kërkesë për revision të aktgjykimit ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata e Qarkut ka refuzuar ankesën e paditësit për anulim të kontratës. Gjykata Supreme ka vendosur se gjykatat e shkallës më të ultë e kanë aplikuar drejtë ligjin duke pasur parasysh faktin se kontrata e shitblerjes ishte në formë të shkruar dhe se të gjitha premtimet e dhëna nga palët janë respektuar plotësisht, d.m.th çmimi është paguar dhe prona është dorëzuar; kështu që kontrata ishte e vlefshme, siq parashihej në nenet 103 dhe 104 të LMD, dhe se kontratat e tilla paraqesin bazë ligjore për fitimin e pronësisë mbi ndërtesën afariste që ishte object i shitblerjes nga ana e të paditurit. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e pabazuar.

Rev.nr.198/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: mr.sc.Rifat Zylfiu, kryetar, Shahdane Agani, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani Zylfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses kundërpaditurës N S H T “Turist Kosova”, të cilën e përfaqëson Mustafë Musa, avokat nga Gjilani, kundër të paditurit kundërpaditësit E.A., nga Presheva, me vendbanim në Gjilan, të cilin e përfaqëson Shabi Isufi, avokat nga Gjilani, për anulimin e kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë, sipas revizionit të paditëses, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac.nr.146/04 datë 20 prill 2004, në seancën e mbajtur më 20 korrik 2005, mori

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditëses i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac.nr.146/04 datë

20 prill 2004.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac.nr.146/04 datë 20 prill 2004 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, C.nr.5005/03 datë 6 shkurt 2006, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar anulimin e kontratës nr.226 të lidhur më 24.10.1995 në mes paditëses, si shitëse dhe të paditurit si blerës, për shitjen e lokalit afarist në sipërfaqe prej 42 m², i cili gjendet në ndërtesën banesore në Gjilan në rrugën “28 Nëntori, ngastra kadastrave nr.3676, fletë posedimi nr.3863 ZK. Gjilan, në emër të Ndërmarrjes ndërtimore “Soliter” në Gjilan, ndërsa është pranuar kundër kërkesëpadia me të cilën është vërtetuar ndaj të kundër paditurës se paditësi është pronar i lokalit afarist të përshkruar më sipër, është detyruar e kundër paditura që kundër paditëses t’ia njohë atë të drejtë t’i lejojë kalimin e pronësisë së lokalit dhe ndryshimin e pronësisë në librat e kadastrave në Drejtorinë e gjeodezisë në Gjilan, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësja me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e përmendura të gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që të pranohet kërkesëpadia e paditësit, apo t’i prishen dhe lënda t’i kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimor (LPK), ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave të nevojshme ka vërtetuar se në mes të palëve ndërgjyqëse më 24.tetor 1995, në bazë të ankandit publik të shpallur në Gazetën e përditshme “Bujku” datë 27 shtator 1995, është lidhur kontrata e shitblerjes me të cilën paditësi ia ka shitur të paditurit lokalit afarist, më afër të përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të asaj

gjykate, me çmim prej 616,000 dinarë të atëhershëm të konvertuar në DM 220.000, të cilin blerësi e ka paguar në tërësi në arkën e shitësit dhe shitësi ia ka dorëzuar blerësit objektin e shitblerjes me anë të procesverbalit të hartuar mes përfaqësuesve të palëve kontraktuese. Blerësi lokalit kontestues e ka shfrytëzuar që nga viti 1995, që kur e ka blerë dhe tani është në posedimin e tij.

Paditësja me padi ka kërkuar anulimin e kontratës për shkak se sipas vlerësimit të saj kontrata e shitblerjes është lidhur në kundërshtim me dispozitat e neneve 103 dhe 104 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në kundërshtim me statutin e paditëses, ngase nuk janë respektuar dispozitat e statuti me të cilat është paraparë si kusht për shitjen e pasurisë së paluajtshme shpallja e referendumit të punëtorëve, se shitblerja është bërë në kohën kur në ndërmarrjen paditëse kanë qenë masat e dhunshme të caktuara nga ish pushteti serb dhe se nuk është respektuar instituti i ankandit publik.

E paditura ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, ka paraqitur kundërpadi, ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet ndaj paditëses se e paditura është pronare e lokalit kontestues në bazë të kontratës së shitblerjes.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ngase sipas vlerësimit të asaj gjykate nuk janë plotësor kushtet ligjore për anulimin e kontratës së shitblerjes, ndërsa kundërpadia është e bazuar, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia është e pabazuar, ndërsa kundërpadia është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlersur si të pabazuara thëniet

e cekura në revizion: se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore paraparë nga neni 354 par.2 pika 14, ngase, siç ceket në revizion, në dispozitivin e aktgjykimit nën par.2 theksohet se ngastra kadastrale nr.3676 e regjistruar në f. poseduese nr.3863 Zona e kadastrës Gjilan, evidencohet në emër të Ndërmarrjes “Soliter” në Gjilan, ndërsa gjykatat e instancës më të ulët nuk e kanë sqaruar faktin pse lokali afarist evidencohet në emër të asaj ndërmarrje dhe a mund të detyrohet paditësi që të paditurit t’ia njohë të drejtën e pronësisë në këtë lokal në pronën e asaj ndërmarrje, e cila nuk ishte palë në procedurë dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i paekzekutueshëm, se gjykata e shkallës së dytë nuk i ka vlerësuar pretendimet ankimore, se sipas nenit 18 pika 14 të Statutit të ndërmërmarrjes paditëse të miratuar më 29.11.1992, tjetërsimi i pronës shoqërore mund të bëhet me dhënien e pëlqimit të punëtorëve në referendum, çka nuk është vepruar kështu në rastin konkret, nuk i është bërë fare ofertë Komunës së Gjilanit, e cila ka pasur të drejtën e përparsisë së blerjes së lokalit, nuk është përfillur procedura e ankandit publik, meqë nuk kishte ofertues të tjerë, se në atë kohë kanë qenë masat e dhunshme dhe në atë kohë në qarkullim ka qenë dinari, ndërsa pagesa e çmimit është bërë në DM, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate të revizionit nga shkesat e lëndës nuk del se lokali afarist nuk evidencohet në emër të ndërmarrjes “Soliter” në Gjilan, por ngastra në të cilën gjendet ndërtesa banesore dhe se lokali afarist gjendet në pjesën përdhese të ndërtesës banesore, se evidencimi në fletën poseduese nuk do të thotë se lokali afarist është në pronësi të asaj ndërmarrje, sepse sipas kësaj logjike në pronësi të asaj ndërmarrje do të ishte dashur të ishin edhe të gjitha banesat në atë ndërtesë, çka nuk është ashtu. Detyrimi i të paditurës që t’ia njohë të paditurës të drejtën e pronësisë së lokalit afarist është pa ndikim në ligjshmërinë e aktgjykimit sepse me rëndësi është pjesa e aktgjykimit me të cilën gjykata vërteton të drejtën e pronësisë së titullarit dhe se detyrimi i tillë nuk është me rëndësi ngase ndryshimin e bën drejtoria kompetente e gjeodezisë në bazë të aktgjykimit në procedurën administrative po qe se janë plotësuar kushtet e parapara me dispozitat juridike pavarësisht nga leja e paditësit dhe se gjykata nuk e bën ekzekutimin e tillë. Fakti se, siç ceket se kontrata e shitblerjes është lidhur në kundërshtim me dispozitat e statutit të paditëses, nuk mund të ndikojë në ligjshmërinë e kontratës, ngase me dispozitën e nenit 22 të LMD ndërmarrja, përkatësisht personat juridikë detyrohen që me rastin e sajimit të marrëdhënieve të detyrimeve t’i respektojnë statutet dhe aktet e tjera normative, por kontrata e lidhur në kundërshtim me

dispozitat e atyre akteve mbeten në fuqi, përveç në rast se në rastin kur pala tjetër ka pasur dijeni ose është dashur të ketë, ndërsa i padituri, fakti që ka marrë pjesë në ankandin publik, nuk ka qenë i detyruar të ketë dijeni për përmbajtjen e dispozitave të akteve normative të paditëses. Nuk është cënuar edhe e drejta e përparësisë së blerjes së Komunës së Gjilanit, ngase shitblerja është bërë në bazë të ankandit publik të shpallur në mjetet publike të informimit. Paditësja nuk mund të thirret në lëshimet e saj lidhur me mjetin e pagesës apo procedurën e ankandit të cilën vetë e ka udhëhequr, prandaj fakt se e paditura e ka paguar çmimin e shitblerjes në valutën të cilën e ka kërkuar shitësi dhe se gjatë procedurës kontestimore nuk ka ofruar prova me të cilat ka pasur të meta në procedurën e ankandit, kjo gjykatë e revizionit vlerëson se thëniet e paditësit lidhur me shkeljet procedurale dhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale janë të pabazuara.

Për faktin se kontrata e shitblerjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse është hartuar me shkrim dhe prestimet kontraktuese të ndërsjella në tërësi janë përmbushur ashtu që blerësi e ka paguar çmimin e shitblerjes, ndërsa shitësi ia ka dorëzuar blerësit sendin i cili ka qenë objekt i shitblerjes, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë konkluduar se kontrata e tillë nuk është nule sipas dispozitave të nenit 103 dhe 104 të LMD dhe se përfaqëson bazë ligjore për fitimin e pronsisë së të paditurit në lokalin afarist i cili ka qenë objekt i shitblerjes.

Nga sa u tha më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat është paraqitur revizioni e as ato për të cilat kjo gjykatë e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe me zbatimin e nenit 393 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.198/2004, më 20.07.2005

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc. Rifat Zylfiu

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile - neni 386 LPK- anulimi i kontratës mbi dhuratën revizion i aktgjykimit - revizioni i pranuar neni 395 (1) LPK]

Paditësi paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykatat e shkallës më të ulët kanë vendosur se kontrata mbi dhuratën është nule dhe se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale Nr. 226/50.

Gjykata Supreme ka vendosur për ndryshim e aktgjykimeve të Gjykatave të shkallës më të ulët. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se anlesa e paditësve është e pabazuar.

Rev.nr.208/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zulfiu dhe Osman Tmava, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit H.F., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson Ymer Koro, avokat nga Prizreni, kundër të paditurve komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor avokati publik Ismet Kërçaku dhe NBI “Rahoveci” në Rahovec, për anulimin e kontratës së dhurimit, përkitazi me revizionin e të paditurës së parë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, Ac.nr.273/2003 datë 28.07.2004, në seancën e mbajtur më 20.07.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Pranohet revizioni i paditurës së parë dhe ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, Ac.nr.273/2003 datë 28.07.2004 dhe ai i Gjykatës Komunale Prizren, C.nr.102/1998 datë 25.03.2003, ashtu që refuzohet kërkesëpadia e paditësit që të vërtetohet ndaj të paditurës komuna e Rahovecit se është nule kontrata e dhurimit, e lidhur mes H.F., nga Prizreni, si dhuratëdhënës, në njëri anë, dhe komunës së Rahovecit, si dhuratëmarrës, në anën tjetër, e vërtetuar

pranë Gjykatës Komunale Rahovec, Vr.nr.671/59 datë 02.12.1959, që të vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr.226/50 në vendin e quajtur “Bella-Breg”, me kulturë arë e regjistruar sipas fletësposeduese nr.115 kk Bella Cërkvë-Fortesë, në sipërfaqe prej 0.20,00 ha, e cila në anën veri-perëndimore është në gjatësi prej 93,62 m, në anën veri-lindore është në gjatësi prej 21,25 m, në anën jug-lindore është në gjatësi prej 94,11 m dhe në anën jug-perëndimore është në gjatësi prej 21,25 m, që të obligohen të paditurit që paditësit t’ia dorëzojnë në posedim dhe shfrytëzim të lirë këtë ngastër kadastrale si dhe pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Rahovec të regjistrohet në emër të paditësit si pronar si dhe që të detyrohen të paditurit që paditësit t’ia paguajnë në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 120 € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Rahovec, C.nr.102/1998 datë 26.03.2003, është vërtetuar se është nule kontrata e dhurimit, lidhur në mes H.F., nga Prizreni, si dhuratëdhënës dhe komunës së Rahovecit, si dhuratëmarrëse, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale Rahovec, Vr.nr.671/1959 datë 02.12.1959, që të vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr.226/50 në vendin e quajtur “Bella-Breg”, me kulturë arë e regjistruar sipas fletësposeduese nr.115 kk Bella Cërkvë-Fortesë, në sipërfaqe prej 0.20,00 ha, e cila në anën veri-perëndimore është në gjatësi prej 93,62 m, në anën veri-lindore është në gjatësi prej 21,25 m, në anën jug-lindore është në gjatësi prej 94,11 m dhe në anën jug-perëndimore është në gjatësi prej 21,24 m dhe të obligohen të paditurit që paditësit t’ia dorëzojnë në posedim dhe shfrytëzim të lirë këtë ngastër kadastrale si dhe pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Rahovec të regjistrohet në emër të paditësit si pronar. Me pjesën II të dispozitivit janë detyruar të paditurit që paditësit të paguajnë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 120 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Gjykata e Qarkut Prizren me aktgjykimin Ac.nr.273/2003 datë 28.07.2004, e ka refuzuar ankesën e të paditurit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale Rahovec C.nr.102/98 datë 26.03.2003.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura e parë me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e cekura të gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në revizion me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se mes H.F., nga Prizreni si dhuratëdhënës, në njërën anë, dhe komunës së Rahovecit, si dhuratëmarrës, në anën tjetër më 02.12.1959 është lidhur kontratë e dhurimit, me të cilën dhuratëdhënësi ia ka dhuruar dhuratëmarrëses ngastrën kadastrale në tërësi në vendin e quajtur “Bello breg” në sipërfaqe prej 0.20.00 ha e cila evidentohet në listën poseduese në emër të H.F. nga Bella Cërkvë e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale Rahovec, Vr.nr.671/1959 datë 02.12.1959. Kjo ngastër, sipas kësaj kontrate, ka kaluar në pronësi shoqërore në emër të komunës së Rahovecit, kurse shfrytëzuesi i saj ka qenë NBI “Rahoveci” në Rahovec.

Paditësi më 07.04.1995, ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet ndaj të paditurës së parë se është nule kontrata e dhurimit, e lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe të detyrohen të paditurit që paditësit t'ia dorëzojnë në posedim dhe shfrytëzim të lirë ngastrën kadastrale nr.226/54 e evidencuar sipas listës poseduese nr.115 kk Bella Cërkvë si dhe t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në seancën për shqyrtimin kryesor të datës 26.03.2003, paditësi e ka precizuar kërkesëpadinë ashtu që ka kërkuar të vërtetohet

se ndaj të paditurës së parë është nule kontrata e dhurimit lidhur mes paditësit si dhuratëdhënës, në njërën anë, dhe komunë së Rahovecit, si dhuratëmarrës, në anën tjetër e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale Rahovec, Vr.nr.671/59 datë 02.12.1959 se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr.226/50 në vendin e quajtur “Bella-Breg” me kulturë arë e regjistruar sipas fletësposeduese nr.115 kk Bella Cërkvë- Fortesë, në sipërfaqe prej 0.20,00 ha e cila në anën veri-perëndimore është në gjatësi prej 93,62 m, në anën veri-lindore në gjatësi prej 21,25 m, në anën jug-lindore në gjatësi prej 94,11 m dhe në anën jug-perëndimore prej 21,25 m dhe të detyrohen të paditurit që paditësit t'ia dorëzojnë këtë ngastër kadastrale në posedim dhe shfrytëzim të lirë, pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Rahovec të regjistrohet paditësi si pronar si dhe të obligohen të paditurit që paditësit t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave dëgjimin e dëshmitarëve M.F., R.P., të dy nga Prizreni, ka vërtetuar se paditësi kontratën e cila është objekt shqyrtimi në këtë kontest, është lidhur me të paditurën e parë nën ndikimin e presionit, ngase, siç ceket në arsyetimin e aktgjykimit të asaj gjykate, nga anëtarët e Komisionit të Komitetit Komunal të Rahovecit, për ta formuar kompleksin e tokës kolektive në pronësi shoqërore, përndryshe do ta largonin nga marrëdhënia e punës.

Duke u mbështetur mbi një gjendje të tillë të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se kontrata e dhurimit, e lëshuar mes palëve kontraktuese, është nule, nuk prodhon efekt juridik dhe me zbatimin e nenit 103 par.1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës së parë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se aktgjykimi nuk përmban shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, të cilat ajo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e vërtetuar faktike, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës më të ulët nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, ngase, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, mbi gjendjen e tillë të vërtetuar

faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur ato gjykata kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Kjo nga fakti se kontrata e dhurimit, e cilat është lidhur më 02.12.1959, siç del nga fotokopja e kontratës që ndodhet në shkresat e lëndës, në rastin konkret nuk mund të zbatohen dispozitat e LMD, i cili ka hyrë në fuqi më 01.10.1978, dispozitat e të cilit, sipas nenit 1106 të këtij Ligji, nuk do të zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve të sajara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për faktin se, siç ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, pala kontraktuese në cilësi të dhuratëdhënësit e ka falur tokën e vet, e cila ka qenë objekt i kontratës së dhurimit nën presionin e anëtarëve të Komisionit të Komitetit Komunal të atëhershëm se, po qe se nuk e bën atë do ta largojnë paditësin nga marrëdhënia e punës, i cili në atë kohë ka qenë në marrëdhënie pune, nuk mund të konkludohet se kontrata e tillë është absolutisht nule, ngase, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kërcënimi në fjalë nuk ka qenë i natyrës së tillë që të mund të krijonte rrezikshmëri serioze për jetën, trupin ose ndonjë vlere të rëndësishme të palës kontraktuese, ngase paditësi nëse ka qenë në marrëdhënie pune, atij i ka mundur t'i pushojë marrëdhënia e punës sipas kushteve dhe procedurës së paraparë me ligj dhe se ai ka mundur të kërkojë mbrojtje juridike pranë gjykatës kompetente. Edhe po të supozohet që të ketë pasur mungesë të shprehjes së vullnetit të palës kontraktuese për shkak të kërcënimit, lajthimit apo mashtrimit, sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile, kontrata e tillë do të ishte relativisht e pavlefshme dhe se anulimi i kontratës për arsye të tilla mund të kërkohej në afat prej një viti, nga dita e marrjes në dijeni të shkakut të rrëzueshmërisë, pushimit të shkakut të kërcënimit, ndërsa e drejta e tillë humbet në afatin objektiv prej tri vjetësh.

Për faktin se kanë kaluar të gjitha afatet për kërkimin e nulitetit relativ të kontratës, të cilat afate janë prekluzive, në rastin konkret nuk mund të kërkohej nuliteti i kontratës pas skadimit të afatit prej 36 vjetësh, siç ka vepruar paditësi në rastin konkret.

Nga arsyet e cekura si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kjo Gjykatë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe, për shkak se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale, u desh që të dy aktgjykimet e atyre gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia, si e tillë, të refuzohet.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 395 par.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.208/2004, më 20.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme duke vendosur mbi Procedurën Civile neni 386 LPK dorëzimi në posedim i patundshmërisë revizion i aktgjykimit revizioni i pranuar urdhërimi për rigjykim (me përjashtim të pjesës II) - neni 395 (1) LPK]

Paditësi paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Paditësi me sukses paraqiti anesë ndaj Gjykatës së shllallës së pare me të cilën kërkonte që të vërtetohet si pronar i patundshmërisë së lartpërmendur. Gjykata Supreme ka vendosur që të pranohet revizionin e paditësit dhe të prishet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac.Nr.195/2004 të datës 04.10.2004, duke ja kthyer lëndën gjykatës së njëjtë për rigjykim. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë në pjesën II të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesa e paditësit është e bazuar.

Rev.nr.210/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr.Rifat Zylfiu, Meleqe Behxheti, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe dr.sc.Hamdi Podvorica, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Sh.A., nga Prishtina, të cilën e përfaqëson Xhafer Maliqi, avokat nga Vushtrria, kundër të paditurit I.B., nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson Adem Vokshi, avokat nga Mitrovica, për dorëzimin në posedim të paluajtshmërisë, përkitazi me revizionin e paditëses paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ac.nr.195/2004 datë 04.10.2004, në seancën e mbajtur më 26.07.2005, mori këtë,

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditëses-kundërpaditurit dhe prishet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ac.nr.195/2004 datë 04.10.2004, ndërsa lënda i kthehet të njëjtës gjykatë për gjykim.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë në pjesën II të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, Ac.nr.195/2004 datë 04.10.2004, është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Vushtrri, C.nr.112/2004 datë 05.07.2004, që ka të bëjë me pjesën I të dispozitivit ashtu që hidhet poshtë kërkesëpapia e paditëses-kundërpaditurit, që të detyrohet i padituri-kundërpaditësi që paditëses t'ia kthejë në posedim faktik patundshmërinë në sipërfaqe prej 1/3 nga fleta poseduese nr.250 kk Vushtrri-përkatësisht ngastrën kadastrale nr.1085 në vendin e quajtur “Qytet” me kulturë shtëpi dhe oborr në sipërfaqe prej 0.04.36 ha, ngastrën kadastrale nr.2034 në vendin e quajtur “Selishte”, arë e klasës së tretë në sipërfaqe prej 0.52.87 ha, ngastrën kadastrale 2.036/1 në vendin e quajtur “Seliste”, në sipërfaqe prej 0.14.10 ha, ngastrën kadastrale nr.2445, në të njëjtin vend, me kulturë arë e klasës së dytë në sipërfaqe prej 0.06.53 ha si dhe ngastrën kadastrale nr.3496/1 në vendin e quajtur “Mrtvaja” arë e klasës së tretë, në sipërfaqe prej 0.38.38 ha si dhe pjesën e ngastrës nr.2034 në sipërfaqe të mbetur prej 01.06.23 ha, e cila paditëses i takon në pronësi sipas aktvendimit mbi trashëgiminë T.nr.65/59 datë 23.03.1961 dhe i plotfuqishëm prej datës 15.04.1961. Me pjesën II të dispozitivit aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën II dhe III të dispozitivit është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësja me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë të ndryshohet ose aktgjykimi i shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja, me padinë e paraqitur gjykatës së shkallës së parë 02.10.1978 ka kërkuar që të vërtetohet ndaj të paditurve se ajo është pronare e paluajtshmërisë të lartpërmendur. Gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin, C.nr.244/2002, me të cilën pjesërisht është pranuar kërkesëpapia e paditëses, i cili aktgjykim, sipas ankesës së paditurit, me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë,

Ac.nr.356/2003 datë 10.05.2004, është prishur dhe lënda i është kthyer për rigjykim gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin, C.nr.112/2004 datë 05.07.2004, me të cilin në pjesën I të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditëses si e pabazuar dhe në pjesën II të dispozitivit është refuzuar kundërpadia e të paditurit-kundërpaditëses si e pabazuar.

Sipas ankesës së paditëses paraqitur kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, me aktgjykimin e goditur të gjykatës së shkallës së dytë është ndryshuar aktgjykimin i Gjykatës Komunale Vushtrri, C.nr.112/2004 datë 05.07.2004, në pjesën I të dispozitivit ashtu që është hedhur poshtë kërkesëpadia e paditëses-kundërpaditurës dhe në pjesën II dhe III të dispozitivit aktgjykimin i shkallës së parë është vërtetuar, me arsyetimin se paditësja ka kërkuar me padi që të vërtetohet pronësia kontestuese dhe kthimin e patundshmërisë në posedim nga baza e trashëgimisë dhe konsideron se në rastin konkret ka të bëjë me çështje të gjykuar më parë në mënyrë të plotfuqishme, për këtë arsye në bazë të nenit 333 par.2 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore kërkesëpadinë e paditëses e ka hedhur poshtë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se aktgjykimin i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 354 par.1 lidhur me nenin 333 par.2 të LPK, për të cilën arsye ky u desh të priset.

Sipas dispozitës së nenit 332 par.2 të LPK, gjykata gjatë gjithë procedurës kujdeset kryesisht nëse çështja është gjykuar në formë të prerë, e po qe se vërtetohet se kontestimi ka filluar mbi kërkesën rreth së cilës është marrë vendimi i formës së prerë, do të hedhë poshtë padinë. Përkundër faktit të ekzistimit të aktvendimit të formës së prerë T.nr.65/59 datë 23.03.1961, nuk mund të merret se është fjala për çështje të gjykuar. Kjo ngase, forma e prerë e aktvendimit të gjykatës trashëgimore nuk e përjashton të drejtën të kërkohej dorëzimi në posedim të paluajtshmërisë. Me fjalë të tjera, edhe kur nuk ka pasur mosmarrëveshje ndërmjet trashëgimtarëve rreth faktit se a hyn ndonjë pasuri në pasurinë trashëgimore, dhe mu për këtë arsye palët nuk janë udhëzuar në kontest, aktvendimi për trashëgimi nuk e përjashton të drejtën e palëve trashëgimore që të paraqesin padi për dorëzimin në posedim të paluajtshmërisë së pasurisë të caktuar, që është përfshirë në

aktvendimin e formës së prerë të trashëgimisë. Kjo ngase për t'u konsideruar një çështje si çështje e gjykuar në formë të prerë, kërkohej të ekzistojë identiteti i palëve, identiteti i kërkesës dhe identiteti i gjendjes faktike. Kontesti paraprak duhet të jetë zhvilluar dhe përfunduar në procedurën kontestimore, sepse si çështje e gjykuar me formë të prerë konsiderohet vetëm ajo çështje kontestuese lidhur me të cilën në procedurën kontestimore është dhënë aktgjykimin.

Në rastin konkret kërkesa e mëparshme mbështetet në një ngjarje jetësore nga koha e marrjes së aktvendimit të formës së prerë të trashëgimisë, kurse kërkesa e re mbështetet në një ngjarje jetësore nga koha e ngritjes së padisë së re. Këto ngjarje jetësore i përkasin një lloji të njëjtë, por nuk janë identike, gjë që i bën të ndryshme ato. Për këtë arsye në këtë rast nuk ekziston identiteti i bazës faktike të kërkesës së mëparshme dhe kërkesës së re, prandaj gjykata e shkallës së dytë për atë arsye nuk mund ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të hedhë poshtë padinë.

Ngase sipas nenit 385 par.3 të LPK, nuk mund të paraqitet revizioni për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, thëniet e revizionit për “mos vërtetimin e gjendjes faktike”, Gjykata Supreme nuk i vlerësoi.

Meqë aktgjykimin i shkallës së dytë në pjesën II të dispozitivit nuk është goditur me revizion, në këtë pjesë aktgjykimin ka mbetur i pashqyrtuar.

Gjykata e shkallës së dytë në rigjykim është e detyruar t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura dhe të vendosë përsëri sipas ankesës në mënyrë meritore.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e neni 394 par.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.210/2004, më 26.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Civile neni 386 LPK anulimi i kontratës revizion i aktgjykimit revizioni i refuzuar neni 395 (1) LPK]

Paditësi paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka shkelur dispozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykatat e shkallës më të ulët kanë vendosur se kontrata mbi shitblerjen e ngastrës kadastrale është nule dhe pa efekt juridik.

Gjykata Supreme ka vendosur për se Gjykatat e shkallës më të ulët gjatë vlerësimit të gjendjes faktike në mënyrë të drejtë kanë aplikuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe në mënyrë të drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, kur kanë vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.

Rev.nr.211/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylifu, Shahdane Agani, Vjosa Nimani-Zylifu dhe Gjuran Dema, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve S.Gj., F.Gj. dhe B.Gj., të gjithë nga Mitrovica, të cilët i përfaqëson Gani Tigani avokat nga Prishtina, kundër të paditurit A.D., nga Mitrovica të cilin e përfaqëson A.H. të cilin e përfaqëson Adem Vokshi avokat nga Mitrovica, për anulimin e kontratës, përkitazi me revizionin e paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac.nr.83/2004 datë 08.07.2004, në seancën e mbajtur më 20.07.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë Ac.nr.83/2004 datë 08.07.2004.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Mitrovicë Ac.nr.83/2004 datë 08.07.2004, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Mitrovicë C.nr.398/2003 datë 16.01.2004, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadija e paditësve, që të vërtetohet se kontrata mbi shitblerjen e placit Vr.nr.1590/2001 datë 19.11.2001 e lidhur në mes të F.Gj., M.Gj. dhe të paditurit është nule dhe se si e tillë nuk prodhon kurfarë efekti juridik. Janë detyruar paditësit që të paditurit t'ia paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 304,20 në emër të shpenzimeve të procedurës në afat prej 15 ditësh.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësit me kohë kanë paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i shkallës së parë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 386 të LPK, gjeti se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se si bashkëpronarët e parcelës kadastrale nr.638 me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 01,90, ha, oborr në sipërfaqe prej 05,00 ha dhe kopsht në sipërfaqe prej 02,28 ha, janë shpallur trashëgimtarët B.Gj., më 1/12, F.Gj., 1/12, S.Gj., 4/12, F.Gj., 5/12, ndërsa M.Gj. në 1/12 të paluajtshmërisë e cila evidentohet në fletën poseduese nr.2573 KK Mitrovicë. Sipas kontratës mbi shitblerjen e placit të vërtetuar në Gjykatën Komunale Mitrovicë Vr.nr.1590/2001 të datës 19.11.2001, dy bashkëpronarët F. dhe M.Gj., pjesët e tyre bashkëpronësore ia kanë shitur të paditurit dhe atë: F. 6/12 ndërsa M. 1/12 parcelës kadastrale me kulturë, shtëpi, oborr dhe kopsht, të klasës së III në sipërfaqe prej 02,28 sipas fletës poseduese nr.2573 KK Mitrovicë, për çmimin e shitblerjes prej 130.000 DM. Mes palëve nuk është kontestuese fakti se në patundshmërinë kontestuese ka ekzistuar shtëpia e cila është djegur gjatë luftës në vend të së cilës është ndërtuar shtëpia e re. Pas vërtetimit të kontratës për shitblerjen e patundshmërisë i padituri sipas fletës poseduese evidencohet si bashkëpronar i së njëjtës në 6/12. Paditësit me padi kërkojnë anulimin e kontratës, për arsye se në

momentin e shitblerjes, në patundshmëri nuk ka ekzistuar shtëpia e cila është e djegur, ashtu që mendojnë se toka ndërtimore përjashtohet nga qarkullimi, dhe nuk mund të lidhet kurrfarë kontrate mbi shitblerje. Sipas nenit 103 të LMD, ajo kontratë është nule dhe si e tillë nuk prodhon kurrfarë efekti juridik.

Gjykata e shkallës së parë, me administrimin e provave, ka gjetur se kontrata e cila është objekt shqyrtimi në këtë kontest nuk është lidhur në kundërshtim me dispozitën e nenit 103 të LMD, dhe se me provat e administruara është vërtetuar se në momentin e lidhjes së kontratës kontestuese ka ekzistuar objekti i ndërtimit i djegur gjatë luftës, mirëpo i padituri në ndërkohë e ka rrënuar dhe ka ndërtuar objektin tjetër.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat ajo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e vërtetuar faktike, gjeti se gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke shtuar se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 103 par.1 të LMD, për anulimin e kontratës për shitblerjen e paluajtëshmëris, respektivisht kontrata nuk përmban asnjë rrethanë që ka ndikuar që ajo të jetë lidhur në kundërshtim me dispozitat imperative dhe me rendin juridik. Me paragrafin 2 të nenit 103 të LMD, është parashikuar që në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njërën anë, kontrata do të mbetet në fuqi, në qoftë se në ligj nuk është parashikuar diçka tjetër për rastin e caktuar, ndërsa pala që e ka shkelur ndalesën ligjore do të pësojë pasojë përkatëse. Në rastin konkret edhe sikur të kishte ekzistuar ndonjë ndalesë e shitjes shitësve, ajo nuk kishte për të ekzistuar në anën e blerësit në rastin konkret të paditurit.

Në revizionin e paditësve vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimet e gjykatave përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pa u sqaruar konkretisht se

cilat janë ato, andaj kjo gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale. Të pabazuara janë edhe thëniet në revizion që gjykatat gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale lidhur me nenin 103 të LMD, sepse aktgjykimet përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike, prandaj edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat të instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar.

Thëniet në revizion përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike nuk janë vlerësuar nga kjo gjykatë, meqë në kuptim të nenit 385 par.3 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 393 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Rev.nr.211/2004, më 20.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti